



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 201

Tiranë – E mërkurë, 18 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 882, datë 12.11.2020	Për miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr. TF0B2002, për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin Suedez të Besimit, për projektin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri.....	14293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 12.11.2020	Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin e mundësimit të turizmit dhe infrastrukturës.....	14300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 4.11.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të godinës së Bashkisë Kurbin e caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese.....	14331
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020	Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara.....	14331
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 889, datë 11.11.2020	Për disa shtesa në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar.....	14336
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 21, datë 14.10.2020	Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 8451/4, datë 5.1.2015, “Për caktimin e çmimit dhe tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare”.....	14336
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 2.11.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar.....	14337

Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 609, datë 6.11.2020	Për rregullat e hollësishme për informacionin që duhet të përmbajnë paketimet e produkteve kozmetike, të cilat nuk janë të parapaketuara, që pakëtohen në pikën e shitjes sipas kërkesës së blerësit ose parapaketohen për shitje të menjëhershme.....	14339
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 610, datë 6.11.2020	Për miratimin e rregullores “Mbi përdorimin e nanomaterialeve në produktet kozmetike”	14341
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13521, datë 11.11.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	14344
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13522, datë 16.11.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.....	14344
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6278/7, datë 12.11.2020	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga bulevardi ‘Bajram Curri’, bulevardi ‘Petro Nini Luarasi’, rruga “Taulantia”, rruga ‘Ali Demi’, Tiranë”	14344
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Florenc Bame.....	14348



VENDIM

28 maj 2020

Nr. 882, datë 12.11.2020

**PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT
NR. TF0B2002, PËR FINANCIMIN
SHITESË NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE
GRANT TË SIGURUARA NGA
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR
(SIDA), NËN FONDIN SUEDEZ TË
BESIMIT, PËR PROJEKTIN E
SHËRBIMEVE MJEDISORE
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr. TF0B2002, për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Agjencia për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin Suedeze të Besimit, për projektin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Sh.S. Anila Denaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tiranë

Republika e Shqipërisë

**Projekti Shqiptar i Shërbimeve Mjedisore
Fondi Suedeze i Besimit nr. TF0B2002
Letërmarrëveshje – Financimi Shtesë**

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi), datë 28 maj 2019, jam e kënaqur t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore), që vepron si administrator i fondeve të granteve të dhëna nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA (Donatori) nën Fondin Suedeze të Besimit për Fondin e Besimit të Projektit të Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri (Fondi i Besimit), propozon të shtojë për Përfituesin, Grantin, në një shumë që nuk duhet të kalojë dy milionë dollarë amerikanë (2,000,000 USD) (Grant), për termat dhe kushtet e përcaktuar ose të referuar në këtë letërmarrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin aneksin bashkangjitur, për të ndihmuar për financimin e projektit, të përshkruar në shtojcë (Projekti).

Ky Grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga Donatori. Në përputhje me seksionin 3.02 të Kushteve të Përcaktuara (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e pagesës së Bankës në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga Donatori, nën fondin e sipërpërmendur të besimit, dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat e Grantit është subjekt i disponueshmërisë së fondeve të tilla.

Përfituesi përfaqëson duke konfirmuar Marrëveshjen e tij më poshtë, se është i autorizuar të hyjë në këtë Marrëveshje dhe të zbatojë Projektin, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar ose të referuar në këtë Marrëveshje.

Lutemi konfirmoni Marrëveshjen nga ana e Përfituesit për sa më sipër, duke e nënshkruar dhe vendosur datën në këtë Marrëveshje nëpërmjet një



zyrtari të autorizuar nga Përfituesi dhe kthimin e një kopje të nënshkruar Bankës Botërore. Pas marrjes së kësaj kopjeje të nënshkruar, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Përfituesi për përfundimin e procedurave të brendshme.

Sinqerisht juaji,

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATA
PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR**

Nënshkrimi

Nga _____

Maryam Salim

Menaxher vendi i Bankës Botërore për Shqipërinë,
Evropën dhe Rajonin e Azisë Qendrore

Rënë dakord:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nënshkrimi

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: Anila Denaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Datë 15 tetor 2020

Bashkëlidhur:

1. “Kushtet Standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar për Financimin Grant të bërë nga Banka, nga Fondi i Besimit”, i datës 25 Shkurt 2019.

2. Letra e disbursimit dhe e informacionit financiar e së njëjtës datë me këtë Marrëveshje, së bashku me “Udhëzuesit e disbursimit për financimin e projektit të investimeve”, i shkurtit 2017.

Nr. i Grantit TF0B2002
SHTOJCA

Neni I

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01 Kushtet Standarde. Kushtet Standarde (si të përshkruara në seksionin 1.02 më poshtë) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë seksion:

a) “Sistemi Shqiptar i Informacionit për Pyjet” është kuadri i teknologjisë së informacionit i projektuar të marrë të dhëna ose informacion për pyjet dhe kullotat për të lehtësuar analizimin dhe raportimin për menaxhimin e integruar të pyjeve.

b) “LEK” është monedha e Përfituesit e referuar, gjithashtu, si LEK shqiptar.

c) “Plani Vjetor i Punimeve dhe Buxheti” është plani i punës dhe buxheti i përgatitur në terma vjetorë nga Përfituesi dhe miratuar nga Banka Botërore, në përputhje me 2.03(C) të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje; dhe “Planet Vjetore të Punimeve dhe Buxhetet” janë më shumë se një Plan Vjetor i Punimeve dhe Buxhet.

d) “Udhëzuesi Antikorrupsion” është për qëllime të paragrafit 2, të shtojcës së Kushteve Standarde “Udhëzuesi për Parandalimin dhe Luftimin e Falsifikimit dhe Korrupsionit në Projekte të Financuara nga Hua të IBRD, Kredi të IDA-së dhe Grante”, i datës 15 tetor 2006, dhe rishikuar në janar 2011, si dhe më 1 korrik, 2016.

e) “AZHBR” është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e Përfituesit e krijuar dhe që funksionon në përputhje me ligjin për “Zhvillimin Bujqësor dhe Rural” nr. 9817, i datës 22 tetor, 2007 ose pasuesi ligjor i tij.

f) “Përfituesit” janë individët dhe organizatat e përzgjedhura për të marrë Nëngrante nën pjesën 2(b) të Projektit, në përputhje me kriteret e parashikuara në Manualin Operacional të Granteve.

g) “Kategori” është kategoria e parashikuar në tabelën e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje.

h) “Planet e Menaxhimit për Pyjet dhe Kullotat Komunale” ose “PMPKK” janë një instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunitetet ku parashikohen masat e komunitetit afatshkurtra,



afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e tokave pyjore dhe kullimore për të paktën 10 vjet.

i) “Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale” ose “SHPPKK” janë organizata joqeveritare që përfshijnë anëtarë të komuniteteve që përdorin burimet pyjore dhe kullimore brenda një zone të një njësie rurale të qeverisë vendore.

j) “Planet e Menaxhimit të Mikrobaseneve Komunale” ose “PMMBK” janë një instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunitetet ku parashikohen masat e komunitetit afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e tokave pyjore dhe kullimore dhe ato bujqësore për të paktën 10 vjet.

k) “Këshilli i Ministrave” është dega ekzekutive e qeverisë së Përfituesit kryesuar nga Kryeministri.

l) “Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes” është departamenti në Kryeministri i ngritur dhe që vepron në përputhje me urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 15.8.2019.

m) “Departamenti i Bashkisë për Pyjet” është zyra e Përfituesit në nivel bashkiak përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

n) “Kuari i Menaxhimit Mjedisor” ose “KMM” është kuari i përgatitur nga Përfituesi nën Projektin Original, datë 11 nëntor, 2013, i shpallur në 23 janar 2014, dhe rishpallur më 14 janar 2020, duke përcaktuar modalitetet për shqyrtim mjedisor dhe procedura për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit mjedisor nën projektin, dhe terma të tillë përfshijnë të gjitha planifikimet dhe shtojcat e KMM-së.

o) “Plani i Menaxhimit Mjedisor” ose “PMM” është në përputhje me secilin prej aktiviteteve të Projektit, në mbështetje të të cilëve KMM-ja kërkon një plan menaxhimi mjedisor, i përgatitur në përputhje me dispozitat e seksionit 2.03(D) të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje; dhe “P_{MM}” do të thotë më shumë se një PMM.

p) “Marrëveshja e Grantit të GEF-së” është marrëveshja e datës 25 korrik 2014 ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore, që vepron si Agjenci Zbatuese e Fondit për Mjedis Global (GEF), duke siguruar Grantin për Përfituesin për të mbështetur me financim pjesët 1(a), 2(a) dhe 3 të Projektit Original, dhe një marrëveshje e tillë mund të përditësohet nga koha në kohë. “Marrëveshja e Grantit të GEF-së” përfshin të

gjitha shtojcat, planifikimet dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes së Grantit të GEF-së.

q) “Plani Gjiner i Veprimit” është një plan i zhvilluar nga Përfituesi, datë 7 nëntor 2013, për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në të gjitha aktivitetet e projektit që përbën një pjesë të monitorimit të Projektit dhe sistemit të vlerësimit.

r) “Marrëveshja e Grantit” është marrëveshja e referuar në seksionin 2.03.B.2(c) e shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

s) “Manuali Operacional i Granteve” është manuali i miratuar nga Përfituesi më 4 prill 2017, në përputhje seksionin IV.B.1 (b) (i), të pjesës 2, të Marrëveshjes së Huas me IBRD-në, siç mund të ndryshohet herë pas here pas miratimit paraprak me shkrim të Bankës Botërore.

t) “Marrëveshja e Huas e IBRD-së” është marrëveshja e datës 25 korrik 2014 ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore, për të mbështetur financimin e pjesëve 1(a), 2(c) dhe pjesës 4(a) të Projektit Original.

u) “Agjencia Shtetërore e Kadastrës” është agjencia përgjegjëse e Përfituesit për shërbimin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e ngritur në përputhje me ligjin nr. 111/2018; ose pasuesi ligjor i saj.

v) “Grupi Lokal i Veprimit” ose “GLV” do të thotë partneritet ndërmjet institucioneve publike, privatit dhe shoqërisë civile në nivel rajonal për zhvillimin e zonës rurale.

w) “Njësitë e Qeverisjes Vendore” ose “NJQV” janë komunat ose bashkitë.

x) “Autoriteti Menaxhues në MBZHR” është Departamenti i Zhvillimit Rural në MBZHR.

y) “MBZHR” është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Përfituesit ose pasuesi ligjor i saj.

z) “MFE” është Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Përfituesit ose pasuesi ligjor i saj.

aa) “Federata Kombëtare e SHPPKK-së” është një organizatë kombëtare jofitimprurëse, e cila përfaqëson interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në territorin e Përfituesit.

bb) “Inventari Kombëtar i Pyjeve” ose “IKP” është regjistri i të dhënave mbi pyjet, të marra nga informacioni i ofruar nga imazhet satelitore, me qëllim krijimin e një vlerësimi kombëtar për mënyrën se si ka ndryshuar mbulesa e pyjeve dhe volumi i pyjeve brenda një periudhe të caktuar.

cc) “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e Përfituesit e krijuar në përputhje me



vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29 janar 2014, për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit ose pasuesit ligjor të saj.

dd) “Kostot Operative” janë kosto me rritje të arsyeshme graduale që dalin nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzime për pajisje për stafin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe AZHBR-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të Projektit, përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, dietat për nëpunësit civil (përfshirë pagat për nëpunësit civil), orenditë, materialet dhe furnizimet, kostot e komunikimit, kostot e promovimit dhe të karburantit për vizitat në terren.

ee) “Projekti Origjinal” është projekti i pasqyruar në pjesën 1 të Marrëveshjes së Huas me IBRD dhe Marrëveshjes së Grantit me GEF-në.

ff) “Pagesa për Shërbimet Mjedisore” është pagesa që u ofrohet individëve apo grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të tokës apo praktikave më të mira.

gg) “Pagesa për Shërbimet në Ujëmbledhës” është pagesa që u ofrohet individëve apo grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të ujëmbledhësve.

hh) “Pagesa për Shërbimet në Ujëmbledhës” është pagesa që u ofrohet individëve apo grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të ujëmbledhësve.

ii) “Njësia e Menaxhimit të Projektit” është njësia e Përfituesit e përbërë nga staf i nominuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, koordinatori i Projektit, specialisti i prokurimit, specialisti i menaxhimit financiar dhe staf plotësues për rekrutim nga Projekti, në përputhje me seksionin 2.03.A.1, të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

jj) “Manuali Operacional i Projektit” është manuali i përgatitur në përputhje me seksionin 2.03.B.1 të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje dhe i konfirmuar si i kënaqshëm nga Banka, i miratuar nga Përfituesi, ku përshkruhen dhe përcaktohen procedurat dhe rregullimet institucionale për zbatimin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet e rregulloret e zbatueshme, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e Projektit.

kk) “Komiteti Drejtues i Projektit” është komiteti drejtues i Përfituesit, i referuar në

seksionin 2.03.A.2 të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

ll) “Kushtet Standarde” janë Kushtet Standarde të “Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar për Financimin e Grantit të kryer nëpërmjet Bankës nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019, me modifikimet e përcaktuara në shtojcë.

mm) “Nëngrante” janë grantet për përfituesit e pranueshëm për të realizuar Nënprojektet.

nn) “Nënprojekt” është nënprojekti i përzgjedhur dhe i miratuar nga Përfituesi për t’u financuar nga Nëngranti, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Manualin Operacional të Granteve.

oo) “Trajtime dhe Seminare” janë kostot e arsyetuara, të miratuara nga Banka Botërore, për trajtime dhe seminare të mbajtura me këtë Projekt, përfshirë të mësuarit, kostot e udhëtimit dhe ushqimit për pjesëmarrësit në seminare dhe trajtime, kosto të shoqëruara me sigurimin e shërbimeve për trajnerët dhe folësve në seminare, qiratë e lidhura me organizimin e seminareve dhe trajtimeve, përgatitja dhe riprodhimi i materialeve të trajtimeve dhe seminareve, dhe kosto të tjera të lidhura direkt me kursin e trajnimit dhe përgatitjen dhe zbatimin e seminarit (përfshirë mallrat dhe shërbimet e konsulentëve).

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01 Objektivat dhe Përshkrimi i Projektit. Objektivi i Projektit është të mbështesë praktikatat e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe të rrisë përfitimet monetare dhe jomonetare të komuniteteve në zona të caktuara të zbatimit të Projektit, të cilat shtrihen kryesisht në zona të larta rurale të prekshme nga erozioni.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit

a) Forcimi i kapaciteteve të Përfituesit për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, duke përfshirë:

i. përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve për të zbuluar ndryshimet dhe për të dhënë informacion se si ka ndryshuar mbulesa e pyjeve



dhe volumi i pyjeve për periudhën e ndërhyrjes për të cilën është rënë dakord;

ii. zhvillimin e një IKP të shtrirë në 10 vjet ku sipërfaqet provë për mbulesën e pyjeve dhe volumin monitorohen në baza vjetore për një periudhë 10-vjeçare;

iii. mbështetje për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve, në pyje shtetërore me funksion prodhues duke përfshirë zonat e mbrojtura;

iv. krijimin e Sistemit Shqiptar të Informacionit për Pyjet;

v. forcimin e kapaciteteve të Departamentit Bashkiak të Pyjeve për të përmbushur detyrimet e tij, duke përfshirë monitorim të pavarur të pyjeve; dhe

vi. regjistrimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara të njësitë e qeverisjes vendore nga qeveria qendrore.

b) Realizimi i aktiviteteve për të fuqizuar Përfituesit, duke përfshirë NJQV-në, SHPPKK-në, dhe fermerët për të përdorur praktika të qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe kullotave, duke përfshirë:

i. zbatimin e Planit Gjikor të Veprimit për të nxitur barazinë gjinore në menaxhimin e burimeve natyrore;

ii. mbështetjen e GLV-ve për të kontribuar në strategjinë e zhvillimit rural;

iii. trajnimin e NJQV-ve dhe SHPPKK-ve për përdorim të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe tokave bujqësore; dhe

iv. nxitjen e gjenerimit të të ardhurave rurale nëpërmjet analizës së zinxhirëve të vlerave, dhe përgatitjes së planeve afatshkurtër dhe afatmesëm të përpunimit dhe marketimit të produkteve pyjore.

Pjesa 2. Planifikimi dhe Dispozita mbi Nënprojektet për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokave

a) Realizimi i aktiviteteve për përgatitjen dhe zbatimin e PMMBK-së për përmirësimin e menaxhimit të tokave, përfshirë:

i. zhvillimin e udhëzimeve për përgatitjen e PMMBK-së për të promovuar përdorimin e burimeve natyrore;

ii. përgatitjen e PMMBK-së për komuna të tjera; dhe

iii. përmirësimin e PMPKK-së ekzistuese, të cilat përfundojnë brenda jetëgjatësisë së Projektit, në PMMBK.

b) Sigurimin e Nëngranteve për përfituesit e pranuar për të zbatuar Nënprojekte.

c) Forcimin e kapaciteteve të drejtorive rajonale të Pyjeve, Zyrave Pyjore Rajonale, AZHBR dhe grupimeve të tjera të përfshira në shërbime këshillimore në fushën e bujqësisë dhe pyjeve, si edhe të aplikantëve për të realizuar detyrimet e tyre gjatë Projektit.

Pjesa 3: Prezantimin e Pagesave për Shërbime Mjedisore

Krijimin e mekanizmave financues për zvogëlimin e degradimit të tokave dhe mbështetjen e mjeteve të jetesës të qëndrueshme, përfshirë:

a) Përgatitjen e studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe krijimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe verifikimit, për përcaktimin sasior të karbonit të fiksuar nga aktivitetet e Projektit;

b) Zhvillimin e mekanizmave për pagesat e shërbimeve në Ujëmbledhës, për të garantuar pagesat nga ana e përfituesve të shërbimeve mjedisore kundrejt atyre të cilët mundësojnë këto shërbime; dhe një model për lidhjen mes praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit; dhe

c) Pilotimin e mekanizmit të Pagesave për Shërbimet në Ujëmbledhës në zonat e përzgjedhura.

Pjesa 4: Mbështetje e Zbatimit të Projektit

a) Realizimin e aktiviteteve për zbatimin e Projektit përfshirë, furnizimin me bazë materiale, ngritjen e kapaciteteve të personelit dhe zbatimin e masave mbrojtëse të mjedisit.

b) Furnizimi dhe instalimi i sistemit informatik për monitorimin e Projektit, për përkrahjen efektive të ndjekjes së aktiviteteve të projektit; dhe realizimin e sondazheve, kryerjen e auditimeve mjedisore dhe monitorimin e vlerësimit.

2.02. Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi do të realizojë Projektin përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e AZHBR-së, në përputhje me: a) neni II i Kushteve Standarde; b) Udhëzime Antikorrupsion; dhe c) këtij neni II.

2.03. Marrëveshjet institucionale dhe të tjera.

A. Marrëveshjet institucionale

1. Ekipi i Menaxhimit të Projektit



Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, gjatë kohës së zbatimit të Projektit do të ketë një Ekip të Menaxhimit të Projektit ku përfshihet edhe koordinatori i Projektit, të cilët do të kenë funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, përfshirë koordinimin e shpejtë dhe efikas, zbatimin komunikimin e përditshëm të lidhur me aktivitetet dhe rezultatet e Projektit.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

a) Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, gjatë kohës së zbatimit të Projektit do të ketë një Komitet Drejtues të Projektit (KDP) me përbërje, mandate dhe terma reference të pranueshme nga ana e Bankës.

b) Pa kufizime në përgjithësinë e sa më sipërme, KDP-ja do të kryesohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe do të përfshijë Drejtorin e Projektit, përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Autoritetit Menaxhues të MBZHR-së, AKM-së, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, AZHBR-së, MFE-së, Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, Këshillit të Ministrave, kryetarit të një komune dhe të Federatës Kombëtare të SHPPKK-së.

c) Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të mundësojë mbledhjen e KDP-së të paktën dy herë në vit dhe do të ketë përgjegjësinë për të siguruar mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit, duke përfshirë, ndër të tjera: i. ofrimin e udhëzuesve strategjikë e politikë; ii. lehtësimin e koordinimit të aktiviteteve të Projektit, dhe dhënien e rekomandimeve për heqjen e çdo pengese për zbatimin e Projektit; dhe iii. kontrollin e progresit të bërë drejt arritjes së objektivave të Projektit.

3. Komiteti Teknik i Projektit

a) Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, gjatë kohës së zbatimit të Projektit do të ketë një Komitet Teknik të Projektit (KTP) të kryesuar nga Drejtori i Projektit përfshirjen e Koordinatorit të Projektit, koordinatorëve të pjesëve përbërëse dhe stafit teknik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencive të tjera të përfshira në zbatimin e projektit; me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme nga Banka Botërore, duke përfshirë: i. sigurimin e cilësisë në aspektet teknike të Projektit; ii. miratimin e Planit Vjetor të Punës dhe Buxhetit të propozuar për t'u kaluar më pas në Bankë Botërore; dhe iii. mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit.

b) Pa kufizime mbi dispozitat e paragrafit “a” më sipër, Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të mundësojë mbledhjen e KTP-së të paktën një herë në dy muaj.

B. Marrëveshjet e Zbatimit

1. Manuali Operacional i Projektit

Pa kufizime të dispozitave të nenit II të Kushteve Standarde, Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të sigurojë që:

a) Projekti zbatohet në përputhje me Manualin Operacional të Projektit; dhe

b) Manuali Operacional i Projektit ose ndonjë pjesë e tij nuk ndryshohet, hiqet, pezullohet ose shfuqizohet pa pajtueshmërinë me shkrim të Bankës, dhe në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dispozitave të Manualit Operacional të Projektit dhe atyre të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Nënprojektet

Për qëllimin e zbatimit të pjesës 2(b) të Projektit, Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të sigurojë, që:

a) Përfituesit e përzgjedhur për të marrë Nëngrante janë përzgjedhur në përputhje me kriteret e parashikuara në Manualin Operacional të Granteve.

b) Nënprojektet përzgjidhen, vlerësohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e procedurat e pranueshme nga Banka Botërore të parashikuara në Manualin Operacional të Granteve; përfshirë, kërkesat:

i. Nënprojekti i përzgjedhur duhet të zbatojë një PMPK ose PMMBK, ose të përmirësojë praktikën e menaxhimit të tokave, ose të mundësojë komunitete dhe fermerë me mundësi alternative të ardhurash për jetesë;

ii. të jetë teknikisht i mundshëm, i zbatueshëm ekonomikisht dhe financiarisht; dhe

iii. nuk do të përfshijë zhvendosje të pavullnetshme.

c) Përpara zbatimit të çdo Nënprojekti të caktuar, Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të bazojë çdo Nëngrant në një Marrëveshjeje Granti me Përfituesin përkatës, me terma dhe kushte të miratuar nga Banka Botërore, të cilat do të përfshijnë si më poshtë:

1. Nëngranti do të emërtohet në lekë; dhe

2. Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ketë të drejtat e duhura për mbrojtur interesat e tij dhe të Bankës Botërore, përfshirë të



drejtat për: i. të pezullojë apo përfundojë të drejtën e Përfituesit për të përdorur të ardhurat e Nëngrantit ose për të përfituar rimbursim të plotë ose të pjesshëm të Nëngrantit të tërhequr, pas dështimit të Përfituesit për të përmbushur detyrimet e tij ndaj Marrëveshjes së Grantit; A. Kryerjen e Nënprojektit me përgjegjshmëri dhe efikasitet dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e duhura teknike, ekonomike, financiare, menaxheriale dhe mjedisore të pranueshme nga Banka Botërore, përfshirë përputhshmërinë me dispozitat e Udhëzuesit Antikorrupsion të zbatueshme edhe për të tjerë përfitues të Grantit përveç Përfituesit; B. Sigurimin, e menjëhershëm sipas nevojave, të burimeve të nevojshme për qëllimin; C. Prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të financuara nga Nëngranti në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje; D. Përdorimin e politikave dhe të procedurave të duhura për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e progresit të Nënprojektit dhe realizimin e objektivave të tij, në përputhje me indikatorët e pranueshëm nga Banka Botërore; E. 1. përdorim të sistemit të menaxhimit financiar dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me standardet kontabël të pranueshme nga Banka Botërore, për të reflektuar punën, burimet dhe shpenzimet në lidhje me Nënprojektin; dhe 2. auditimin e këtyre pasqyrave financiare nga auditues të pavarur, me kërkesë të Bankës Botërore apo të Përfituesit, në përputhje me standardet e zbatueshme të auditimit të pranueshme për Bankën Botërore, dhe kalimin e menjëhershëm të pasqyrave të audituara të Përfituesit dhe Banka Botërore; F. Mundësimin e Përfituesit dhe Bankës për të inspektuar Nënprojektin, punën e bërë dhe regjistrimet e dokumentacionin përkatës; dhe G. përgatitjen dhe dorëzimin e informacioneve të kërkuar nga Përfituesi dhe Banka Botërore për sa më sipër.

d) Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrojë të drejtat e tij nën çdo Marrëveshje Granti për të mbrojtur interesat e Përfituesit dhe të Bankës Botërore dhe për të përmbushur qëllimin e Nëngrantit; dhe përveç rastit të dakordësisë së Bankës Botërore, Përfituesi nuk do të ndryshojë, shfuqizojë ose të heqë dorë nga Marrëveshja e Grantit ose nga ndonjë prej dispozitave të tij.

C. Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti

1. Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të përgatisë dhe dërgojë në Bankë Botërore, jo më vonë se data 1 dhjetor i çdo viti fiskal gjatë zbatimit të Projektit, një plan pune dhe buxhet ku përfshihen të gjitha aktivitetet e propozuara për t'u përfshirë në Projekt gjatë vitit të ardhshëm fiskal, dhe propozimin e një plani financiar për shpenzimet e lidhura me këto aktivitete, duke paraqitur shumat e propozuara dhe burimet e financimit.

2. Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do t'i mundësojë Bankës Botërore një afat të përshtatshëm për të shkëmbyer pikëpamjet me Përfituesin mbi planin e punës dhe buxhetin e propozuar, duke mundësuar kështu zbatimin e Projektit me kujdesin e duhur përgjatë vitit fiskal në vazhdim, në përputhje me planin e punës dhe buxhetin e miratuar nga Banka Botërore (Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti).

3. Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nuk do të kryejë ose lejojë kryerjen e ndryshimeve në Planin Vjetor të Punës dhe Buxhet pa marrë dakordësisë e me shkrim të Bankës Botërore.

D. Masat Mbrojtëse

Përfituesi, përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e KMM-së. Për këtë qëllim, nëse ndonjë aktivitet i përfshirë në Planin Vjetor të Punës dhe Buxhet, do të kërkonte përgatitjen e një PMM-je, Përfituesi do të sigurohet që asnjë aktivitet i tillë të mos zbatohet nëse dhe deri kur një PMM për këto aktivitete është: i. përgatitur, në përputhje me KMM-në dhe dërguar në Bankë Botërore si pjesë e Planit Vjetor të Punës dhe Buxhetit; ii. shfaqet lokalisht, sipas kërkesave të KMM-së; dhe iii. miratohet nga Banka Botërore dhe shfaqet publikisht.

2.05 Monitorimi i Projektit, Raportimi dhe Vlerësimi

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të sigurohet që çdo Raport Tremujor i Projektit do t'i dërgohet Bankës jo më larg se 1 (një) muaj pas secilit tremujor.



Artikulli III

Tërheqja e të Ardhurave të Grantit

3.01 Shpenzime të Pranueshme. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit, në përputhje me dispozitat: a) neni III i Kushteve Standarde; dhe b) këtë pjesë; për të financuar Shpenzimet e Pranueshme në shumën e caktuar dhe, nëse e aplikueshme, deri në përqindjen e vendosur në secilën Kategori në tabelën në vazhdim:

Kategoria	Shuma e Grantit (në USD)	% e Shpenzimeve të Financuara (përfshirë Taksat)
1. Mallra, Shërbime Konsulence dhe Jokonsulence, Trajnime, Kosto Operacionale nën pjesën 2(a) të Projektit	1,000,000	100%
2. Nënprojekte nën pjesën 2(b) të Projektit	1,000,000	100%
SHUMA TOTALE	2,000,000	

3.02 Kushtet e Tërheqjes. Pavarësisht dispozitave të pjesës 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të kryhet asnjë tërheqje për pagesa të kryera përpara datës së kësaj Marrëveshjeje.

3.03 Periudha e Tërheqjes. Data e Përfundimit është 31 maj 2021.

Artikulli IV

Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat

4.01 Përfaqësuesi i Përfituesit. Përfaqësuesi i Përfituesit referuar në pjesën 7.02 të Kushteve Standarde është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

4.02 Adresa e Përfituesit. Për qëllim të pjesës 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Përfituesit është:

Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë

Republika e Shqipërisë; dhe

b) Adresa elektronike e Përfituesit është:

Facsimile:Email:

355 42228494sekretariamin@financa.gov.al

4.03 Adresa e Bankës. Për qëllim të pjesës 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development/International Development Association

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Telex:Facsimile:

248423 (MCI) or 1-202-477-6391

64145 (MCI)]

VENDIM

Nr. 883, datë 12.11.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTITNDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROGRAMIN E MUNDËSIMIT TË TURIZMIT DHE INFRASTRUKTURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin e mundësimit të turizmit dhe infrastrukturës, në shumën prej 40 000 000 (dyzet milionë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VERSIONI I NËNSHKRUAR
(Numri i veprimt: 49351)

MARRËVESHJE GRANTI

“PROGRAMI I MUNDËSIMIT TË TURIZMIT
DHE INFRASTRUKTURËS” NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË DHE
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM
MBËSHTETUR NGA FONDET IPA TË BE-së
DATË 8 TETOR 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I – PËRKUFIZIME DHE

INTERPRETIM

Seksioni 1.01 Përkufizime

Seksioni 1.02 Interpretimi

NENI II – FINANCIMI ME GRANT

Seksioni 2.01 Shuma dhe qëllimi

Seksioni 2.02 Disbursime të Financimit me
Grant

Seksioni 2.03 Disbursime

Seksioni 2.04 Taksat dhe detyrimet

NENI III – KUSHTET PARARENDËSE

Seksioni 3.01 Disbursimi i parë i financimit me
Grant për shërbimet e konsulencës

Seksioni 3.02 Disbursimi i parë i financimit me
Grant për mallrat, punimet dhe shërbimet e tjera

Seksioni 3.03 Të gjitha disbursimet e financimit
me Grant

NENI IV – DËTYRIMET E MARRËSIT DHE TË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTT

Seksioni 4.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

Seksioni 4.02 Kryerja e punës dhe veprimtarive

Seksioni 4.03 Përdorimi i financimit me Grant

Seksioni 4.04 Përputhshmëria me Marrëveshjen
e Huas

Seksioni 4.05 Prokurimi

Seksioni 4.06 Kontratat

Seksioni 4.07 Sigurimi

Seksioni 4.08 Evidenca dhe raporte financiare

Seksioni 4.09 Dhënia e informacionit

Seksioni 4.10 Mashtrimi dhe korrupsioni

Seksioni 4.11 Vizibiliteti

Seksioni 4.12 Inspektimi dhe auditimi

NENI V – DEKLARATA DHE GARANCI

Seksioni 5.01 Deklarata

Seksioni 5.02 Pranimit dhe përsëritja

NENI VI – PEZULLIMI DHE ANULIMI

Seksioni 6.01 Anulimi nga Marrësi ose Agjencia
e Zbatimit të Programit

Seksioni 6.02 Pezullimi ose anulimi i
disbursimeve

Seksioni 6.03 Rastet e rimbursimit

Neni VII – TË NDRYSHME

Seksioni 7.01 Kushte dhe zgjidhja

Seksioni 7.02 Qëndrimi në fuqi përtej
Marrëveshjes

Seksioni 7.03 Marrëveshja e plotë; Ndryshime
dhe Heqja dorë

Seksioni 7.04 Njoftimet

Seksioni 7.05 Gjuha angleze

Seksioni 7.06 Të drejta, mjete juridike dhe heqja
dorë

Seksioni 7.07 Përgjegjësia dhe dëmshpërblimi

Seksioni 7.08 Konflikti i interesit

Seksioni 7.09 Legjislacioni Rregullues

Seksioni 7.10 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Seksioni 7.11 Privilegjet dhe Imunitetet e
BERZH-it

Seksioni 7.12 Pasuesit dhe të caktuarit ; të
drejtat e palëve të treta

Seksioni 7.13 Nxjerrja e të dhënave

Seksioni 7.14 Dublikatat

PASQYRA A: FORMULARI I KËRKESËS PËR
DISBURSIM PËR KONTRATAT E
KONSULENCËS A-1

PASQYRA B: FORMULARI I KËRKESËS SË
DISBURSIMIT PËR KONTRATA MALLRASH,
PUNIMESH DHE SHËRBIEMESH B-1

PASQYRA C: FORMULARI I SHKRESËS QË
CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR C-1

SKEDULI 1: ZËRAT E FINANCUAR NGA
GRANTI, S1-1

SKEDULI 2: PËRSHKRIMI I PROJEKTT, S2-1

SKEDULI 3: TERMA DHE KUSHTE TË
KONTRATËS, S3-1

SKEDULI 4: KONTRIBUTE JOMONETARE,
S4-1

SKEDULI 5: RAPORTIMI GJYSMËVJETOR,
S5-1

SKEDULI 6: KRITERET E PRANIMIT PËR
NËNPROJEKTET, S6-1

**MARRËVESHJE GRANTI**

Kjo Marrëveshje Granti (kjo “Marrëveshje”) e datës 8 tetor 2020, lidhet ndërmjet:

1. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një institucion financiar ndërkombëtar i ngritur bazuar në Marrëveshjen që krijon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një traktat shumëpalësh i nënshkruar në Paris më 29 maj 1990, me seli në “One Exchange Square”, London EC2A 2JN, United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar) (BERZH);

2. Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi); dhe

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit (“Agjencia e Zbatimit të Programit” dhe, së bashku me BERZH-in dhe Përfituesin, “Palët”).

Duke pasur parasysh se:

A. BERZH-i (në cilësinë e tij si huadhënës) ka lidhur një marrëveshje huaje me Përfituesin (në cilësinë e tij si huamarrës) më 8 tetor 2020, në zbatim të së cilës BERZH-i ka rënë dakord për të dhënë hua një shumë prej 60 milionë eurosh, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar në marrëveshjen e huas, që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshja e Huas), për të financuar pjesën e Projektit (siç përkufizohet më poshtë).

B. Në zbatim të nenit 20 të Marrëveshjes që krijon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bashkimi Evropian (Donatori), i ka ofruar BERZH-it financim për Programin e Mbështetjes së Turizmit në Shqipëri për Zhvillimin Ekonomik Vëndës BERZH-BE, në përputhje me numrin e marrëveshjes së kontributit ENI/399-876, të datës 14 dhjetor 2018 (Marrëveshja e Kontributit).

C. Krahas termave dhe kushteve të përcaktuar në Marrëveshjen e Kontributit, BERZH-i ka rënë dakord të zgjerojë një Grant me një shumë totale deri në 40,000,000 euro nga Donatori, prej të cilave 33,330,000 euro do të menaxhohen nga Marrësi (përmes Agjencisë të Zbatimit të Programit), bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Marrëveshje, për prokurimin e disa Zërave të Financuara nga Granti (siç përkufizohet më poshtë). 6,670,000 eurot e mbetura do të menaxhohen nga BERZH-i.

D. Në përputhje me Kontratën e Kontributit, Agjencia e Zbatimit të Programit ka rënë dakord

për të përzgjedhur dhe për të angazhuar Konsulentë (siç përkufizohen më poshtë), duke lidhur Kontratat e mëposhtme të Konsulencës (siç përkufizohen më poshtë), në zbatim të të cilave çdo Konsulent do të ofrojë asistencë teknike:

i. një kontratë në zbatim të së cilës Konsulenti do të ofrojë asistencë teknike, me qëllim ofrimin e trajtimit për të përmirësuar aftësitë e fuqisë punëtore të ofruesve të produktit/shërbimit të turizmit vëndës, nxitjen e pjesëmarrjes së grave në zinxhirin e vlerave të turizmit në Shqipëri dhe trajnimin për të përmirësuar aftësitë në restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore (ID-ja e detyrës TCRS (73734));

ii. një kontratë në zbatim të së cilës Konsulentët do të ofrojnë asistencë teknike, me qëllim për t'i ardhur në ndihmë Agjencisë së Zbatimit të Programit, lidhur: i. përgatitjen e projektit dhe kryerjen e mbikëqyrjes së punimeve; dhe ii. kujdesin e duhur teknik dhe për të mbështetur zbatimin e projektit. Gjithashtu, Konsulenti do të asistojë Agjencinë e Zbatimit të Programit lidhur me kategorizimin e çdo projekti, në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it dhe me hartimin e termave të përshtatur të referencës për të mundësuar kujdesin e duhur mjedisor dhe social (ID-ja e detyrës TCRS (73733)); dhe

iii. një kontratë në zbatim të së cilës Konsulenti do të ofrojë asistencë teknike, me qëllim rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së produkteve të turizmit të integruar në Berat, Korçë, Shkodër dhe Fier (ID-ja e detyrës TCRS (69028)).

E. Agjencia e Zbatimit të Programit ka rënë dakord për të përzgjedhur dhe për të angazhuar Kontraktues (siç përkufizohen më poshtë), duke lidhur kontrata për ofrimin e mallrave, punimeve dhe/ose shërbimeve (secila siç përkufizohet më poshtë), siç përshkruhen më poshtë në këtë dokument.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Përkufizime dhe interpretim**Seksioni 1.01 Përkufizime**

a) Me përjashtim kur përkufizohen në pikën “b” më poshtë, përveç nëse konteksti përcakton ndryshe, termat me shkronja të mëdha që përkufizohen në termat dhe kushtet standardë kanë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.



b) Sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë klauzolat, pasqyrat skedulet), përveç nëse konteksti përcakton ndryshe, termat me shkronja të mëdha kanë kuptimet e mëposhtme:

“Ditë pune” është një ditë (përveç të shtunës ose të dielës), kur bankat tregtare janë të hapura për aktivitet të përgjithshëm në Londër, Angli.

“Konsulentë” është çdo konsulent me imazh dhe reputacion të mirë, me njohuri dhe përvojë të vërtetuar për fushën, i përfshirë (ose për t'u përfshirë) nga Agjencia e Zbatimit të Programit, në lidhje me prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës.

“Kontratë Konsulencë” është çdo Kontratë e lidhur (ose për t'u lidhur) ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit dhe Konsulentit përkatës, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in, e cila përfshin termat dhe kushtet e përcaktuar në skedulin 3 (Termat dhe Kushtet e Kontratës) për realizmin e Shërbimeve të Konsulencës.

“Shërbime Konsulencë” janë Shërbimet që do të ofrohen nga çdo Konsulent, në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti për t'u financuar sipas pjesëve 1. A, 1. B dhe 2. A të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti), siç përshkruhen më poshtë në Termat e Referencës të përcaktuar në Kontratën e Konsulencës.

“Kontratë” është çdo marrëveshje e lidhur (ose për t'u lidhur) ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit dhe Konsulentit ose Kontraktuesit përkatës, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in, e cila përfshin termat dhe kushtet e përcaktuar në skedulin 3 (Termat dhe Kushtet e Kontratës).

“Kontraktues” është çdo kontraktues me imazh dhe reputacion të mirë, me përvojë pune përkatëse të mëparshme dhe të vërtetuar, i përfshirë (ose për t'u përfshirë) nga Agjencia e Zbatimit të Programit, në lidhje me prokurimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve.

“Marrëveshje Kontributi” ka kuptimin e dhënë në recitalin B.

“Disbursim” është disbursimi i çdo pjese të Financimit me Grant, herë pas here, sipas seksionit 3.02 (Të gjitha Disbursimet e Financimit me Grant).

“Kërkesë për Disbursim” është një kërkesë për Disbursim, në formularin e pasqyrës A (Formulari i Kërkesës për Disbursim për Kontratat e Konsulencës), lidhur me Kontratat e Konsulencës

dhe në formularin e pasqyrës B (Formulari i Kërkesës për Disbursim për Kontratat e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve), lidhur me Kontratat e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve dhe, në çdo rast, në përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in, e cila i dorëzohet BERZH-it në përputhje me seksionin 2.02(a) (Disbursimet e Grantit).

“Donator” ka kuptimin e dhënë në recitalin B.

“Sistemi i Zbulimit të Hershëm dhe Përjashtimit” është baza e të dhënave të të gjithë personave juridikë dhe fizikë të përjashtuar nga financimi i BE-së, e krijuar nga Komisioni Evropian sipas Rregullores (BE, Euratom) nr. 2015/1929 (OJ L 286/1, 30.10.2015).

“Kriteret e Pranimit” nënkuptojnë kriteret e pranimit për vlerësimin e Nënprojekteve, sikundër është parashtruar në skedulin 6 në këtë dokument.

“Politika dhe Procedurat e Zbatimit” janë Politika dhe Procedurat e Zbatimit të BERZH-it, të datës 4 tetor 2017, të ndryshuara herë pas here, dhe çdo politikë ose procedurë e miratuar nga BERZH-i si pasuese ose zëvendësuese e këtyre politikave dhe procedurave.

“Mallra” janë produkte të prekshme, si pajisje kancelarie, pajisje zyre, mobilie, harduer kompjuterik, softuer standard “i gatshëm”, teknologji informacioni, pajisje audiovizuale, fotokopje, mjete motorike etj., siç përshkruhet më tej në skedulin 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

“Zërat e Financuar nga Granti” janë Mallra, Punime, Shërbime dhe Shërbime Konsulencë të nevojshme për Projektin, dhe për t'u financuar tërësisht ose pjesërisht nga Granti dhe për t'u menaxhuar nga Përfituesi (nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit), siç përshkruhen më tej në skedulin 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

“Financim me Grant” ka kuptimin e dhënë në seksionin 2.01(a) (Shuma dhe Qëllimi).

“Infrastrukturë” nënkupton objektet fizike që mundësojnë shërbime me rëndësi për publikun e përgjithshëm dhe që janë të nevojshme për zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

a) sektorin e energjisë elektrike: impiantet e prodhimit të energjisë dhe rrjetet e shpërndarjes së energjisë;

b) sektorin e telekomunikacionit: sistemet për komunikimet telefonike vendëse dhe në distancë dhe rrjetet e transmetimit të të dhënave;

c) sektorin e ujit: impiantet e desalinimit,



impianetet e trajtimit të ujërave të ndotura, strukturat e shpërndarjes së ujit;

d) sektorin e pastrimit: strukturat dhe pajisjet për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve;

e) sektorin e transportit: instalimet fizike dhe sistemet e përdorura për transportin publik, të tilla si: hekurudhat urbane dhe ndërrurbane, trenat nëntokësore, linjat e autobusëve, rrugët, urat, tunelet, portet, linjat ajrore dhe aeroportet; dhe

f) rigjenerimin e infrastrukturës urbane: instalimin e ndriçimeve të reja rrugore dhe riparimin e hapësirave për këmbësorët dhe/ose shëtitoret.

“Marrëveshje Huaje” ka kuptimin e dhënë në recitalin A.

“Financim me Hua” është financimi i bërë ose për t’u vënë në dispozicion nga Banka për Marrësin në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas.

“OLAF” ka kuptimin e dhënë në seksionin 4.08(c)(iii) (Evidencat dhe Raportet Financiare).

“Politikat dhe Rregullat e Prokurimit” janë rregullat e prokurimit të BERZH-it për operimet e sektorit publik, në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

“Praktikë e Ndalar” ka kuptimin e dhënë në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

“Projekti” ka kuptimin e dhënë në skedulin 2.

“Mekanizmi i Ankesave të Projektit” është mekanizmi i llogaridhënies i BERZH-it, i parashikuar në Rregulloren e Mekanizmit të Ankesave të Projektit, i majit 2014, dhe për rrjedhojë kjo rregullore mund të ndryshohet, plotësohet ose zëvendësohet herë pas here.

“Shpagim” është çdo veprim direkt ose indirekt dëmtues i rekomanduar, i paralajmëruar ose i ndërmarrë.

“Shërbime” janë produkte jo të prekshme që përfshijnë ofrimin e kohës, përpjekjeve dhe/ose ekspertizës nga një Kontraktues/Konsulent, si: mirëmbajtje, ofrim trajnimi, analizë dhe këshillim, si dhe licencim dhe mirëmbajtje softuer dhe më shumë asistencë rastësore në formën e qirasë për pajisje etj., siç përshkruhen në skedulin 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

“Terma dhe Kushte Standardë” janë Termat dhe Kushtet Standardë të Bankës, datë 1 tetor 2018.

“Nënprojekt” nënkupton çdo projekt investimi,

që do të financohet nga Huaja në lidhje me Projektin, dhe secili prej tyre do të përmbushë Kriteret e Pranimit.

“Taksë” është çdo taksë, privilegj, pullë ose detyrim tjetër, vlerësim, tarifë, pagesë, tatim mbi vlerën e shtuar ose taksë e çfarëdolloj natyre (duke përfshirë çdo penalitet apo interes të lidhur) të vendosur me ligj.

“Termat e Referencës” janë shërbime për t’u ofruar nga Konsulenti në lidhje me Projektin, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, metodat dhe burimet për t’u përdorur nga Konsulenti dhe/ose rezultatet për t’u arritur.

“Raste të Rimbursimit” është çdo rast apo ndodhi e specifikuar në seksionin 6.03 (Rastet e Rimbursimit).

“Punime” janë veprimtari me një përzierje të Shërbimeve dhe të punës, dhe transferim i Mallrave, por ku elementi i Shërbimeve mbizotëron mbi Mallrat, siç përshkruhet më tej në skedulin 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

a) fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveç kur konteksti përcakton ndryshe;

b) titujt dhe tabela e përmbajtjes përfshihen vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) referenca për një “person” përfshin çdo person, fizik ose juridik, firmë, shoqëri, korporatë, qeveri, shtet ose agjenci shtetërore apo shoqatë, trust ose partneritet (pavarësisht nëse ka ose jo personalitet juridik të veçantë) ose dy apo më shumë nga të sipërpërmendurat, dhe referencat për një “person” përfshijnë pasuesit e tij në titull, të transferuarit dhe të caktuarit e lejuar;

d) fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë, dhe referencat për një person përfshijnë pasuesit e tij dhe të caktuarit e lejuar;

e) referenca për një nen, seksion, skedul ose pasqyrë specifike interpretohet si referencë për atë nen ose seksion, ose skedul apo pasqyrë specifike të kësaj Marrëveshjeje;

f) referenca: i. për një ndryshim ose një marrëveshje për t’u ndryshuar përfshin një shtesë, ndryshim, caktim, novacion, zëvendësim, rideklarim ose rimiratim; dhe ii. për një marrëveshje interpretohet si një referencë për këtë marrëveshje, pasi ajo mund të ndryshohet herë pas here;



g) një Rast i Rimbursimit është i prapambetur ose në vazhdim derisa të jetë kompensuar ose të jetë hequr dorë nga BERZH-i me shkrim;

h) çdo referencë për “ligjin” nënkupton çdo ligj (duke përfshirë të drejtën zakonore) dhe çdo traktat, kushtetutë, statut, legjislacion, dekret, akt normativ, rregull, rregullore, gjykim, urdhër, urdhër gjyqësor, vendim gjyqësor, vendim gjyqi, vendim gjykate ose masë tjetër ligjore apo administrative, ose vendim gjyqësor apo arbitrazhi në çdo juridiksion që ka fuqinë e ligjit ose përputhshmërinë me praktikën e përgjithshme në këtë juridiksion;

i) çdo referencë për një dispozitë ligjore është referencë për atë dispozitë me ndryshimin ose rimiratimin e saj herë pas here;

j) “duke përfshirë” dhe “përfshin” konsiderohet të ndiqen nga “pa u kufizuar” kur diçka e tillë nuk ndodh; dhe

k) “kontroll” (duke përfshirë, së bashku me kuptimet korrelative, termat “kontrolluar nga” dhe “nën kontrollin e përbashkët me”), i përdorur në lidhje me ndonjë person, nënkupton zotërim, qoftë direkt apo indirekt, të fuqisë për të drejtuar ose për të sjellë drejtimin e menaxhimit dhe të politikave të këtij personi, qoftë nëpërmjet zotërimit të aksioneve me të dejtë vote, qoftë nëpërmjet kontratës apo ndryshe.

Neni II

Financimi me Grant

Seksioni 2.01 Shuma dhe Qëllimi

a) Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, BERZH-i bie dakord që t'i japë Marrësit, nga burimet e ofruara nga Donatori, një grant në shumën prej 33,330,000.00 (tridhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë mijë) eurosh (Financimi me Grant).

b) Financimi me Grant do të përdoret vetëm për qëllime të financimit të Zërave të Financuar nga Granti.

c) Sipas seksionit 6.03(b) (Rastet e Rimbursimit), Financimi me Grant nuk është i rimbursueshëm.

d) Secili nga Marrësit dhe Agjencitë e Zbatimit të Programit pranon dhe bie dakord shprehimisht se:

i. BERZH-i nuk do të jetë i detyruar që të bëjë një Disbursim ose pagesë tjetër, sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që fondet e mjaftueshme janë vënë në dispozicion nga

Donatori, sipas Marrëveshjes së Kontributit për këtë qëllim; dhe

ii. Përveç kur kjo Marrëveshje parashikon shprehimisht ndryshe, ai është dhe do të jetë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për çdo detyrim dhe sipërmarrje të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02 Disbursime të Financimit me Grant

a) Sipas seksionit 6.02 (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve) dhe nenit III (Kushtet Pararendëse), BERZH-i disburson Financimin me Grant herë pas here në Ditë Pune, në një ose më shumë Disbursime, me kërkesë të Marrësit. Marrësi mund të kërkojë një Disbursim duke i paraqitur BERZH-it një Kërkesë për Disbursim të paktën 10 Ditë Pune para datës së propozuar të këtij Disbursimi. Çdo dokument mbështetës i dorëzuar së bashku me çdo Kërkesë për Disbursim do të jetë në gjuhën angleze. Përveç kur BERZH-i bie dakord ndryshe, Kërkesa për Disbursim do të jetë e pakthyeshme dhe detyruese për Marrësin.

b) Përveç kur është rënë dakord ndryshe nga BERZH-i, Marrësi, nuk do të kërkojë Disbursim pas datës 14 dhjetor 2023 dhe çdo pjesë e padisbursuar e Financimit me Grant do të anulohet automatikisht në ditën pasardhëse.

c) Përveç kur Palët kanë rënë dakord ndryshe, Disbursimet bëhen vetëm për të financuar kostot e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti.

d) Disbursimet bëhen në monedhën Euro.

e) Disbursimet (të tjera nga e gjithë shuma e padisbursuar e Financimit me Grant) bëhen: i. në shuma jo më pak se 250,000 Euro për Kontratat e Konsulencës; dhe ii. në shuma jo më pak se 500,000 Euro për Kontratat e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve, dhe në secilin rast jo më shumë se një herë në muaj.

Seksioni 2.03 Disbursime

Përveç kur BERZH-i bie dakord ndryshe:

a) Shumat për t'u disbursuar nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje paguhën direkt në llogarinë e Konsulentit ose Kontraktuesit përkatës, siç përcaktohet në faturën përkatëse. BERZH-i kryen pagesa vetëm nëpërmjet pagesës elektronike në një llogari bankare në emër të Konsulentit ose të Kontraktuesit dhe që ndodhet:

i. në vendin e korporatës ose vendbanimin e Konsulentit ose të Kontraktuesit përkatës, sipas rastit; ose



ii. me pëlqimin paraprak të BERZH-it, në vendin ku ofrohen Shërbimet e Konsulencës.

b) Nëse afati i caktuar për një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bie në një ditë që nuk është Ditë Pune, atëherë kjo pagesë bëhet e pagueshme në Ditën pasuese të Punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e detyrueshme për t'u paguar ndaj BERZH-it sipas kësaj Marrëveshjeje, paguhet menjëherë, pa kompensim ose kundërpretendim, nga fondet e disponueshme në Euro, në vlerën në datën e pagesës, në llogarinë që BERZH-i, herë pas here, mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin. Të gjitha pagesat ndaj BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të kenë dhe të përfshijnë, dhe pa zbritje ose mbajtje për ose për shkak të, asnjë taksë, detyrim, tarifë apo pagesë të çfarëdolloj natyre.

Seksioni 2.04 Taksat dhe Detyrimet

a) Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit paguan, kur është afati, të gjitha Taksat që vendosen ndaj tij dhe të pagueshme për, ose në lidhje me, ekzekutimin, publikimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje ose çdo dokumenti tjetër lidhur me këtë Marrëveshje.

b) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit pranojnë dhe bien dakord se asnjë pjesë e shumës së Financimit me Grant nuk përdoret, direkt apo indirekt, për të paguar ndonjë Taksë, qoftë direkte ose indirekte, në Shqipëri ose tjetërkund.

c) Nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e pagueshme sipas Kontratave:

i. Agjencia e Zbatimit të Programit e informon BERZH-in sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme;

ii. Agjencia e Zbatimit të Programit i paguan drejtpërdrejt Konsulentit ose Kontraktuesit një shumë të barabartë me taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në); dhe

iii. në çdo Kërkesë për Disbursim, Marrësi vërteton se ka paguar një shumë të barabartë me taksa të tilla indirekte për fatura të mëparshme të Konsulentit ose Kontraktuesit, dhe merr përsipër të paguajë Taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) për faturën aktuale.

Neni III

Kushtet pararendëse

Seksioni 3.01 Disbursimi i Parë i Financimit me Grant për Shërbimet e Konsulencës

Faqe | 14306

Detyrimi i BERZH-it për të bërë Disbursimin e parë të Financimit me Grant për Shërbimet e Konsulencës është subjekt i përmbytjes paraprake, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in ose heqjes dorë të kushteve pararendëse:

a) BERZH-i ka marrë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të ekzekutuar në mënyrë të rregullt;

b) BERZH-i ka marrë kopje të certifikuar të të gjitha Autorizimeve të nevojshme për ekzekutimin, dorëzimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit; dhe

c) BERZH-i ka marrë shkresë që cakton nënshkruesit e autorizuar të Marrësit kryesisht në formularin e Pasqyrës C (Formulari i Shkresës që Cakton Nënshkruesit e Autorizuar).

Seksioni 3.02 Disbursimi i Parë i Financimit me Grant për Mallrat, Punimet dhe Shërbimet e Tjera

Detyrimi i BERZH-it për të bërë Disbursimin e parë të Financimit me Grant për të gjithë Zërat e Financuar nga Granti, ndryshe nga Shërbimet e Konsulencës, është subjekt i përmbytjes paraprake, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in ose heqjes dorë të kushteve pararendëse:

a) BERZH-i ka marrë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të ekzekutuar në mënyrë të rregullt;

b) të gjitha kushtet pararendëse për efektshmërinë dhe për disbursimin e parë të Financimit me Hua, sipas Marrëveshjes së Huas janë përmbytshur, ndryshe nga Marrësi që lëshon Kërkesën për Disbursim, sipas kësaj Marrëveshjeje, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in;

c) BERZH-i ka marrë një plan të detajuar të prokurimit dhe një skedul Disbursimi për prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti;

d) BERZH-i ka marrë kopje të noterizuara të të gjitha Autorizimeve të nevojshme për ekzekutimin, dorëzimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi; dhe

e) BERZH-i ka marrë shkresë që cakton nënshkruesit e autorizuar të Marrësit kryesisht në formularin e pasqyrës C (Formulari i Shkresës që Cakton Nënshkruesit e Autorizuar).

Seksioni 3.03 Të gjitha Disbursimet e Financimit me Grant

Detyrimi i BERZH-it për të kryer Disbursimin



e Financimit me Grant është po ashtu subjekt i përmbushjes, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in ose heqjes dorë të kushteve që në datën e aplikimit të Marrësit për një Disbursim të tillë dhe në datën e këtij Disbursimi:

a) lidhur me Mallrat, Punimet dhe Shërbimet për t'u financuar, sipas pjesëve 2.B dhe 3 të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti), Marrëveshja e Huas të ketë fuqi dhe efekt të plotë dhe Marrësi të jetë në përputhje me të gjitha detyrimet në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas;

b) deklaratat dhe garancitë e dhëna ose të konfirmuara nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit në këtë Marrëveshje të jenë të vërteta dhe në ato data me të njëjtin efekt, si edhe deklaratat dhe garancitë e dhëna në ato data;

c) asnjë prej rasteve të përshkruara në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve) nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon të ndodhë;

d) si rrjedhojë e një Disbursimi të tillë, Agjencia e Zbatimit të Programit nuk duhet të jetë në shkelje të Statutit të saj apo të ndonjë dispozite të përfshirë në marrëveshje ose instrument palë e të cilit është Agjencia e Zbatimit të Programit (duke përfshirë këtë Marrëveshje), ose me të cilin është e lidhur Agjencia e Zbatimit të Programit, apo ndonjë ligj i zbatueshëm për Agjencinë e Zbatimit të Programit;

e) nuk duhet të ketë ndodhur asnjë rast që, në opinionin e arsyeshëm të BERZH-it, mund të ketë efekt negativ të ndjeshëm të Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Programit ose Projekti;

f) BERZH-i ka marrë një kopje origjinale të Kërkesës në kohë për Disbursim, të bërë nga Marrësi;

g) lidhur me Mallrat, Punimet dhe Shërbimet për t'u financuar, sipas pjesës 3, të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti), BERZH-i të ketë marrë një kërkesë të njëkohshme ose paraprake dhe të kënaqshme për tërheqjen, sipas Marrëveshjes së Huas, si: vlera e kontratës e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve që do të financohen në kuadër të pjesës 3, të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti) nuk kalojnë njëzet (20) për qind të shpenzimeve të agreguara;

h) BERZH-i të ketë marrë një kopje të certifikuar të çdo Kontrate të ekzekutuar dhe çdo fature për të cilën është kërkuar Disbursimi;

i) BERZH-i të ketë marrë konfirmim nga Marrësi, që:

i. Zërat e Financuar nga Granti të jenë ofruar

dhe zbatuar në mënyrë të kënaqshme, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse; dhe

ii. çdo faturë të jetë e drejtë dhe e saktë, dhe të korrespondojë me shumat e përcaktuara në Kontratën përkatëse; dhe

j) BERZH-i të ketë marrë dokumente të tjera, që BERZH-i në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë, duke përfshirë: i. evidenca të tilla si ato të përdorimit të propozuar të shumave të Disbursimit; dhe ii. evidenca të përdorimit të shumave të Disbursimit/eve të mëparshëm.

Neni IV

Detyrimet e Marrësit dhe të Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Përveçse kur BERZH-i bie dakord ndryshe me shkrim:

Seksioni 4.01 Bashkëpunimi dhe Informacioni

a) Dispozitat e seksionit 4.01 (Bashkëpunimi dhe Informacioni) të Termave dhe Kushteve Standardë zbatohen si të paraqitura plotësisht këtu *mutatis mutandis*, pa cenuar përgjithësimin e tyre, sikur:

i. referencat për “Huamarrësin” dhe “Etnitetin e Projektit” lexohen si të ishin referenca për “Marrësin” dhe “Agjencinë e Zbatimit të Programit”;

ii. referenca për “Huan” lexohet si të ishte referencë për “Financimin me Grant”; dhe

iii. referencat për “Marrëveshjen e Huas” dhe “Marrëveshjen e Projektit” lexohen si të ishin referenca për “këtë Marrëveshje”.

b) Kur merr informacion në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Banka mund të përdorë dhe të mbështetet në këtë informacion në cilësinë e saj si ofruese e Financimit me Grant, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Kryerja e Punës dhe e Veprimtarive

a) Marrësi kryen punën dhe veprimtaritë e tij, në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe në pajtim me praktikat e shëndosha financiare, teknike dhe tregtare, duke përfshirë të gjitha ligjet lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, dhe siguron mbrojtjen e duhur të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

b) Agjencia e Zbatimit të Programit:



i. ruan ekzistencën e korporatës së saj, në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme, duke përfshirë të gjitha ligjet lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, dhe siguron mbrojtjen e duhur të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme; dhe

ii. kryen punën dhe veprimtaritë e saj në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe në pajtim me praktikën e shëndosha financiare, teknike dhe tregtare.

c) Secili nga Marrësit dhe Agjencitë e Zbatimit të Programit frenohet nga çdo aktivitet që mund të cenojë ushtrimin e paanshëm dhe objektiv të funksioneve të çdo personi që përmbush detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) në mënyrë që të koordinojë menaxhimin e monitorimit dhe vlerësimin e të gjitha aspekteve të zbatimit të projektit, duke përfshirë rishikimin e progresit kundrejt objektivave dhe për të siguruar pronësinë dhe llogaridhënien, secili prej Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit do t'u sigurojë përfaqësues që të marrin pjesë në komitetin drejtues të themeluar nga BERZH-i dhe donatori, i cili do të mbledhet në baza gjysmëvjetore, afërsisht në prill dhe tetor të çdo viti.

Seksioni 4.03 Përdorimi i Financimit me Grant

Marrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit, e përdor Financimin me Grant në mënyrë rigorozë dhe vetëm për të financuar Zërat e Financuar nga Granti.

Seksioni 4.04 Përputhshmëria me Marrëveshjen e Huas

Marrësi:

a) përmbush në çdo kohë detyrimet e tij në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas;

b) siguron që çdo pjesë e Projektit të financuar nëpërmjet Financimit me Grant të kryhet nga Agjencia e Zbatimit të Programit, në përputhje me detyrimet mjedisore dhe sociale të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas;

c) siguron që Plani i Prokurimit do të dakordësohet midis Huamarrësit, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit dhe BERZH-it, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, të përfshijë Zërat e Financuar nga Granti dhe Kontratat;

d) siguron që aktivitetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Zbatimit të Programit të përfshijnë

prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe zbatimin e Financimit me Grant;

e) siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit merr dhe mban në fuqi (ose, kur është e përshtatshme, rinovon) të gjitha autorizimet e kërkuara, në përputhje me Marrëveshjen e Huas ose ndryshe për Projektin, dhe përmbush dhe respekton të gjitha kushtet dhe kufizimet e përfshira ose të vendosura nga Përfituesi, në këto Autorizime; dhe

f) merr miratimin e BERZH-it, në cilësinë e tij si ofruesi i Financimit me Grant, në përputhje me këtë Marrëveshje, përpara se të bjerë dakord për ndonjë ndryshim në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 4.05 Prokurimi

Dispozitat e seksionit 4.03 (Prokurimi) të Termave dhe Kushteve Standardë zbatohen si të paraqitura plotësisht këtu *mutatis mutandis*, pa cenuar përgjithësimin e tyre, sikur:

a) referenca për “Huamarrësin” lexohet sikur të ishte referencë për “Marrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Programit”;

b) referenca për “shumën e Huas” lexohet sikur të ishte referencë për “shumën e Financimit me Grant”; dhe

c) referenca për “datën e kësaj Marrëveshjeje” lexohet sikur të ishte referencë për “datën e Marrëveshjes së Huas”.

Seksioni 4.06 Kontratat

a) Agjencia e Zbatimit të Programit:

i. siguron që të gjithë Kontratat të përfshijnë dispozitat të kënaqshme për BERZH-in, duke kërkuar që asnjë Konsulent ose Kontraktues të mos përfshihet në asnjë Praktikë të Ndalar ose Shpagim, siç përcaktohet në seksionin 4.10 (Mashtimi dhe Korrupsioni) dhe në seksionin 4.12 (Inspektimi dhe Auditimi); dhe

ii. vë në dispozicion BERZH-it një kopje të certifikuar të të gjitha Kontratave të ekzekutuara jo më vonë se dhjetë ditë nga data e tyre.

b) Agjencia e Zbatimit të Programit nuk bën asnjë ndryshim përmbajtësor (duke përfshirë ndonjë vendim lidhur me caktimin ose nënkontraktimin) në asnjë Kontratë pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it (i cili nuk do të mbahet në mënyrë të paarsyeshme). Në çdo rast, Agjencia e Zbatimit të Programit e njofton BERZH-in për të gjitha ndryshimet përmbajtësore në Kontratë.



Seksioni 4.07 Sigurimi

Agjencia e Zbatimit të Programit mban sigurimin e duhur konform praktikave të shëndosha financiare, teknike dhe detyrimeve ligjore në Shqipëri.

Seksioni 4.08 Evidenca dhe Raporte Financiare

Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit:

a) mbajnë libra të veçantë kontabël dhe evidenca të tjera lidhur me Financimin me Grant, në përputhje IFRS të zbatueshme në vazhdimësi;

b) sigurojnë që autorizimi i dhënë Audituesve në përputhje me Marrëveshjen e Huas, për të komunikuar drejtpërdrejt me BERZH-in, të zgjerohet me informacion të kërkuar nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me Financimin me Grant; dhe

c) mbajnë dokumente dhe evidenca të kontabilitetit financiar lidhur me veprimtaritë e financuara nga Financimi me Grant për jo më pak se 5 vjet pas:

i. datës në të cilën Financimi me Grant është disbursuar i plotë;

ii. datës së fundit për disbursimin e Financimit me Grant, sipas datës së përcaktuar në seksionin 2.02(b) (Disbursimet e Financimit me Grant); dhe

iii. nëse është ndërmarrë një auditim ose hetim nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) ose nga BERZH-i lidhur me Projektin, datës në të cilën ka përfunduar ky auditim ose hetim, dhe i vë këto evidenca në dispozicion të përfaqësuesve të BERZH-it me kërkesë të këtij të fundit.

Seksioni 4.09 Dhënia e Informacionit

a) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit pranon se në marrjen e informacionit në përputhje me Marrëveshjen e Huas, BERZH-i, në cilësinë e tij si huadhënës, mund të përdorë dhe mbështetet në këtë informacion në cilësinë e tij si ofrues i Financimit me Grant, sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Nëse ky informacion nuk i është dhënë BERZH-it, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) ia jep këtë informacion BERZH-it jo më vonë se 31 janari dhe 31 korriku në secilin progresraport vjetor ose gjashtëmujor, në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in, raporte të cilat përfshijnë:

i. informacion të detajuar lidhur me Kontratat, Konsulentët dhe Kontraktuesit, Disbursimet,

Financimin me Grant dhe përdorimin e tij, Zërat e Financuar nga Granti, si dhe statusin e përputhshmërisë me secilin prej angazhimeve të përfshira në këtë Marrëveshje, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in;

ii. informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar BERZH-it që të gjurmojë përdorimin e Financimit me Grant (që dallon nga Financimi me Hua);

iii. informacionin e përcaktuar në formularin e skedulit 5 në këtë dokument (pasi ky formular mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it), duke përfshirë burimet e të dhënave ekzistuese;

iv. informacionin për sfidat e ndeshura, masat e marra për të kapërcyer problemet dhe ndryshimet përfundimtare të paraqitura;

v. një parashikim të disbursimeve të përlogaritura, sipas Financimit me Grant për t'u bërë gjatë periudhës pasardhëse të raportimit gjashtëmujor, duke përfshirë një përshkrim për secilin Zë të Financuar nga Granti; dhe

vi. informacione të tjera të ngjashme lidhur me, ndër të tjera, Marrësi, Agjencinë e Zbatimit të Projektit, Projektin dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje, pasi BERZH-i mund ta ndryshojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme kërkesën.

c) Sa më shpejt që të jetë në dispozicion, por në çdo rast brenda 30 ditësh pas përfundimit ose zgjidhjes së Kontratës së fundit, Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) vë në dispozicion të BERZH-it (nëse kërkohet nga BERZH-i, certifikohet nga Përfaqësuesi i Autorizuar: i. një raport përfundimtar lidhur me përdorimin e Financimit me Grant, i cili do të specifikojë në detaje të gjitha Kontratat, të gjithë Konsulentët dhe Kontraktuesit, Zërat e Financuar nga Granti dhe kalendarët e dorëzimit dhe të ngritjes, dhe krahasimin kundrejt parashikimeve fillestare.

d) Sa më shpejt që të jetë në dispozicion, por në çdo rast brenda 30 ditësh pas përfundimit të Projektit, Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) i sigurojnë BERZH-it (nëse kërkohet nga BERZH-i, certifikohet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit) një raport



përfundimtar lidhur me Projektin, duke identifikuar përdorimin e Financimit me Grant.

e) Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit i mundësojnë BERZH-it, Donatorit dhe përfaqësuesve të tyre, me kërkesë të BERZH-it:

1. Të vizitojë çdo objekt ose kantier ndërtimi lidhur me Projektin;

2. Të kontrollojë çdo mall, punim dhe shërbim të financuar nga shuma e Financimit me Grant, dhe çdo impiant, instalim, kantier, punim, godinë, pasuri, pajisje, evidencë dhe dokument lidhur me përmbushjen e detyrimeve të Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit, sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

3. Për këto qëllime, të takojë dhe të zhvillojë diskutime me këta përfaqësues dhe punonjës të Agjencisë së Zbatimit të Programit, siç Banka mund ta shohë të nevojshme dhe të përshtatshme.

f) Me dhënien e çdo Kontrate, BERZH-i mund të publikojë një përshkrim të saj, emrin dhe shtetësinë e Konsulentit ose Kontraktuesit dhe çmimin e kontratës.

g) Agjencia e Zbatimit të Programit siguron që BERZH-i, Donatori dhe përfaqësuesit e tyre të kenë akses në librat kontabël dhe evidencat e Agjencisë së Zbatimit të Programit lidhur me Projektin dhe Financimin me Grant.

h) Me kërkesë, Përfituesi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit i ofron në kohë BERZH-it evidenca të kënaqshme se Zërat e Financuar nga Granti janë siguruar në përputhje me seksionin 4.07 (Sigurimet).

i) Menjëherë me ndodhjen e ndonjë rasti të përshkruar në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve), Përfituesi (kur gjen zbatim) ose Agjencia e Zbatimit të Programit e njofton BERZH-in për të, duke specifikuar natyrën e këtij rasti dhe çdo hap që Marrësi (kur gjen zbatim) ose Agjencia e Zbatimit të Programit po ndërmarrin për ta rregulluar atë.

j) Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit e njoftojnë BERZH-in në kohë nëse Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit marrin ndonjë informacion lidhur me një shkelje të seksionit 4.10 (Mashtrimi dhe Korrupsioni) ose seksionit 5.01(b) (Deklarata), ose nëse ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ka vendosur sanksione mbi Përfituesin ose Agjencinë e Zbatimit të Programit për ndonjë Praktikë të Ndaluar. Nëse BERZH-i e njofton Marrësin dhe Agjencinë e

Zbatimit të Programit për shqetësimin e tij, se ka pasur një shkelje të seksionit 4.10 (Mashtrimi dhe Korrupsioni) ose 5.01 (b)(Deklarata), Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit, sipas rastit, bashkëpunon në mirëbesim me BERZH-in dhe përfaqësuesit e tij për të konstatuar nëse ka ndodhur një shkelje e tillë.

k) Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit e njofton BERZH-in në kohë për pezullimin ose zgjidhjen, ose për ndonjë rast që mund të ketë sjellë pezullimin ose zgjidhjen e Kontratës.

l) Marrësi (kur gjen zbatim) dhe Agjencia e Zbatimit të Programit vënë në kohë në dispozicion të BERZH-it informacione të tjera të ngjashme pasi BERZH-i ose Donatori mund t'i kërkojnë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 4.10 Mashtrimi dhe Korrupsioni

a) As vetë Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit nuk përfshihen, dhe as autorizojnë ose lejojnë që ndonjë prej nëpunësve të tyre përkatës, drejtorëve, punonjësve të autorizuar, bashkëpunëtorëve, agentëve ose përfaqësuesve, Konsulentëve ose Kontraktuesve të përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndaluar ose Shpagim në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti).

b) Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, si Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit pranon në këtë mënyrë se BERZH-i mund ta deklarojë këtë Marrëveshje si të papërshtatshme për financim dhe mund t'i drejtohet Politikës dhe Procedurave të Zbatimit, si dhe mund të marrë Veprime për Zbatim ose Veprime për Nxjerrjen e të Dhënave (këta terma janë përkufizuar në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit), për sa iu përket pretendimeve për Praktika të Ndaluara në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti).

c) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, Marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) përfshijnë dispozitat e mëposhtme në të gjitha dokumentet e tenderit dhe në të gjitha kontratat lidhur me Zërat e Financuar nga Granti:



i. duke pohuar se vetë furnitorët, nënfurnitorët, kontraktuesit, nënkontraktuesit, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk përfshihen dhe as autorizojnë ose lejojnë që ndonjë prej nëpunësve të tyre, drejtorëve, punonjësve të autorizuar, bashkëpunëtorëve, agjentëve ose përfaqësuesve të përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndaluar ose Shpagim, në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti; dhe

ii. duke njoftuar furnitorët, nënfurnitorët, kontraktuesit, nënkontraktuesit, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët se BERZH-i mund ta deklarojë këtë Marrëveshje si të papërshtatshme për financim dhe mund t'i drejtohet Politikës dhe Procedurave të Zbatimit, si dhe mund të marrë Veprime për Zbatim ose Veprime për Nxjerrjen e të Dhënave (këta terma janë përkufizuar në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit), për sa iu përket pretendimeve për Praktika të Ndaluara në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti.

d) Secili nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit pranon dhe bie dakord, se: i. BERZH-it i kërkohet të informojë Donatorin nëse Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Programit ose ndonjë person tjetër që ka kontroll mbi Marrësin ose Agjencinë e Zbatimit të Programit ka qenë subjekt i ndonjë vendimi të formës së prerë ose vendimi administrativ të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash, vepra terroriste, punë të detyruar të fëmijëve ose trafikim të qenieve njerëzore apo shkelje që prek interesat financiare të Donatorit; ii. BERZH-it i kërkohet të informojë Donatorin nëse ka zbuluar mashtrim ose shkelje lidhur me zbatimin e Projektit; dhe iii. Donatori mund ta përfshijë këtë informacion në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përjashtimit dhe ta publikojë atë në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

Seksioni 4.11 Vizibiliteti

a) Marrësit, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit, marrin masat e nevojshme për të publikuar faktin që Projekti ka marrë financim nga Donatori dhe siguron në veçanti, që:

i. informacioni i dhënë për medien, si dhe të gjitha materialet promocionale, njoftimet zyrtare,

raportet dhe publikimet, të njohin faktin se Projekti është kryer “me financim nga Bashkimi Evropian” dhe të përmbajnë logon e BE-së (dymbëdhjetë yje të verdha në një sfond blu) në mënyrë të përshtatshme;

ii. publikimet lidhur me Projektin (duke përfshirë publikimet elektronike) të mbajnë mospranimin e përgjegjësisë si në vijim: Ky dokument është përgatitur me asistencën financiare të Bashkimit Evropian. Këndvështrimet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian; dhe

iii. nëse pajisjet, mjetet ose furnizimet e mëdha blihen me fondet e BE-së, të shfaqet dëftesa e duhur (duke përfshirë logon e BE-së) në këto mjete, pajisje dhe furnizime të mëdha (përveçse nëse kjo mund të cenojë sigurinë e stafit të Përfituesit).

b) Emri, shkurtesa dhe logoja e BERZH-it janë marka shërbimi të regjistruara, të cilat as Marrësi dhe as Agjencia e Zbatimit të Programit nuk i riprodhojnë pa lejen e shprehur me shkrim të BERZH-it.

Seksioni 4.12. Inspektimi dhe Auditimi

a) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit e lejojnë BERZH-in dhe/ose Komisionin Evropian, OLAF-in, Gjykatën Evropiane të Audituesve ose ndonjë prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar që të kryejnë shqyrtime dokumentacioni dhe kontrole në vend, lidhur me përdorimin e kontributit të Donatorit. Për këtë qëllim, Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) u mundëson BERZH-it dhe/ose Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve ose ndonjë prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar, me kërkesë, që të:

i. vizitojnë çdo objekt, kantier ndërtimi dhe ambient lidhur me Projektin ose ndonjë ambient tjetër ku kryhet puna e marrësit ose e Agjencisë së Zbatimit të Programit;

ii. kenë akses dhe të kontrollojnë çdo Zë të Financuar nga Granti;

iii. kenë akses dhe të inspektojnë çdo aset, libër kontabël, llogari, evidenca, dokumente dhe të dhëna të kompjuterizuara në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti), dhe



lejojnë që këto evidenca dhe llogari të auditohen nga BERZH-i ose përfaqësuesit e tij; dhe

v. takojnë dhe zhvillojnë diskutime me këta përfaqësues dhe punonjës të marrësve dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit, siç BERZH-i mund ta çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme,

në çdo rast, për: x) të lehtësuar monitorimin dhe vlerësimin e Projektit dhe përdorimin e Financimit e Grant; y) t'i mundësuar BERZH-it të shqyrtojë dhe adresojë çdo ankesë të lidhur me Projektin, të depozituar nëpërmjet Mekanizmit të Ankesave të Projektit; dhe z) të vlerësuar nëse ka ndodhur ndonjë Praktikë e Ndalar në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti).

b) Marrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit, siguron që të gjitha llogaritë, evidencat, dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara lidhur me Projektin të jenë të aksesueshme dhe të depozituara, në mënyrë të tillë që të mundësojë në mënyrë të arsyeshme marrëveshjet e lejuara në pikën "a" më sipër.

c) Agjencia e Zbatimit të Programit (në rast të kundërt, marrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit) siguron që në të gjitha dokumentet e tenderit dhe në të gjitha kontratat lidhur me Zërat e Financuar nga Granti të përfshihen dispozita me efektin e pikës "a" më sipër në lidhje me furnitorët, nënfurnitorët, kontraktuesit, nënkontraktuesit, koncesionarit, konsulentët dhe nënkonulentët.

Neni V

Deklarata dhe garanci

Seksioni 5.01 Deklarata

a) Të gjitha deklaratat dhe garancitë e dhëna nga marrësi në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas përsëriten nga marrësi si të paraqitura plotësisht këtu, sikur referenca për "Huamarrësin" lexohet si të ishte referencë për "Marrësin".

b) Agjencia e Zbatimit të Programit garanton dhe i deklaron BERZH-it, se:

i. është themeluar në mënyrë të rregullt dhe ekziston ligjërisht sipas ligjeve të Shqipërisë;

ii. ka kapacitet dhe autoritet të plotë për ta lidhur këtë Marrëveshje në rolin e saj si Agjencia e Zbatimit të Programit dhe për të zbatuar detyrimet e parashikuara në këtë dokument;

iii. kjo Marrëveshje ekzekutohet nga një përfaqësues i autorizuar, në mënyrë të rregullt, i Agjencisë së Zbatimit të Programit;

iv. nuk ka masa, padi ose procedime apo investigime rregullatore pezull ose, në dijeni të Agjencisë së Zbatimit të Programit, që e kërcënojnë ose e ndikojnë atë përpara gjykatës ose organit administrativ apo gjykatës së arbitrazhit, gjë që mund të ndikojë në aftësinë e Agjencisë së Zbatimit të Programit për të përmbushur dhe për të realizuar Projektin dhe detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

v. me ekzekutimin e rregullt, kjo Marrëveshje përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Agjencinë e Zbatimit të Programit.

b) Secili nga marrësit dhe Agjencitë e Zbatimit të Programit garanton dhe deklaron më tej se as marrësi dhe as Agjencia e Zbatimit të Programit, as ndonjë nëpunës, drejtor, punonjës i autorizuar, bashkëpunëtor, agjent ose përfaqësues i marrësit ose i Agjencisë së Zbatimit të Programit nuk ka kryer ose është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndalar ose Shpagim, në lidhje me Projektin, këtë Marrëveshje ose ndonjë transaksion të përcaktuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë Kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti).

Seksioni 5.02 Pranimi dhe Përsëritja

a) Secili nga marrësit dhe Agjencitë e Zbatimit të Programit pranon se ka bërë dhe përsëritur deklaratat dhe garancitë në seksionin 5.01 (Deklarata) dhe seksionin 7.12 (Hegja dore nga imuniteti sovran), me qëllim që ta nxisë BERZH-in të lidhë këtë Marrëveshje dhe të japë Financimin me Grant, dhe se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje në bazë dhe në mbështetje të plotë të çdo deklarate dhe garancie të tillë. Secili nga marrësit dhe Agjencitë e Zbatimit të Programit garanton se nuk ka dijeni për ndonjë fakt ose çështje shtesë, fshehja e të cilave bën çorientuese ndonjë nga këto deklarata dhe garanci.

b) Deklaratat dhe garancitë e parashikuara në seksionin 5.01 (Deklarata) konsiderohen të përsëritura me paraqitjen e çdo kërkesë për Disbursim dhe në çdo datë Disbursimi, përveç ndonjë deklarate ose garancie ku specifikohet se është paraqitur "deri në datën e kësaj Marrëveshjeje".

Neni VI

Pezullimi dhe anulimi

Seksioni 6.01 Anulimi nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit

Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit, herë pas here, jo më përpara se njoftimi paraprak me shkrim prej 40 ditësh për BERZH-in, mund të anulojë tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Financimit me Grant. Çdo njoftim për anulim nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit është i pakthyeshëm dhe detyrues, dhe shumat e Financimit me Grant që janë anuluar mund të mos rikthehen.

Seksioni 6.02 Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve

a) BERZH-i, me anë të një njoftimi me shkrim për Marrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Programit, mund të pezullojë ose të anulojë të drejtën e Marrësit për të kërkuar të gjithë ose një pjesë të çdo shume të padisbursuar të Financimit me Grant, nëse ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë ndonjë nga rastet e mëposhtme:

i. Disbursimi i parë nuk është bërë në datën që është 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë pas datës së kësaj Marrëveshjeje ose në një datë tjetër për të cilën mund të jetë rënë dakord ndërmjet Palëve;

ii. BERZH-i ka pezulluar disbursimet ose ka anuluar të gjithë ose një pjesë të Financimit me Hua ose BERZH-i ka të drejtën të pezullojë disbursimet ose të anulojë të gjithë ose një pjesë të Financimit me Hua, sipas Marrëveshjes së Huas;

iii. Marrësi, në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas, ka anuluar tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Huas;

iv. Marrëveshja e Huas pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë ose është zgjidhur;

v. Marrësi nuk përmbush asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Huas ose Agjencia e Zbatimit të Programit nuk përmbush asnjë nga detyrimet e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje

vi. ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë ndonjë ngjarje e specifikuar në seksionin [7.06] (Ngjarjet e Përshpejtimit) të Termave dhe Kushteve Standardë, dhe BERZH-i ka deklaruar që e gjithë ose një pjesë e Huas detyrohet dhe është e pagueshme;

vii. një deklaratë ose garanci e dhënë nga Agjencia e Zbatimit të Programit ose Marrësi, në

lidhje me këtë Marrëveshje ka qenë e pasaktë ose çorientuese në aspektin përmbajtësor;

viii. është siguruar financim alternativ për Projektin, që çon në financim të dyfishtë (qoftë tërësisht ose pjesërisht);

ix. është ose është bërë e paligjshme në çdo juridiksion që BERZH-i të bëjë, mbajë ose financojë Grantin, ose të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

x. në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të BERZH-it, ky i fundit ka konstatuar se Agjencia e Zbatimit të Programit ose një bashkëpunëtor i Agjencisë së Zbatimit të Programit, apo ndonjë Konsulent ose Kontraktues është përfshirë në një Praktikë të Ndalar ose Shpagim, në lidhje me një Projekt të BERZH-it, dhe se është përfshirë në listën e personave ose subjekteve të BERZH-it që janë të papërshtatshëm për të marrë kontratë të financuar nga BERZH-i, ose për t'u financuar nga BERZH-i (kjo listë mund të gjendet në faqen e internetit të BERZH-it);

xi. është pezulluar ose zgjidhur një Kontratë; me kusht që në këtë rast, BERZH-i mund të pezullojë ose të anulojë të drejtën e Marrësit për të kërkuar pjesë të padisbursuar të Grantit, që financon shumën e kësaj Kontrate;

xii. ndonjë shumë e Financimit me Grant është paguar në mënyrë të parregullt ose është përdorur në mënyrë të gabuar nga Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Programit ose ndonjë Konsulent apo Kontraktuesit, në mënyrë të tillë që nuk përputhet me këtë Marrëveshje ose ndonjë Kontratë në lidhje me Projektin, sipas rastit;

xiii. ka një ndryshim të kontrollit të Agjencisë së Zbatimit të Programit që nuk është i pranueshëm për BERZH-in;

xiv. Agjencia e Zbatimit të Programit bën një marrëveshje vullnetare me kreditorët e saj ose bëhet subjekt i një urdhri administrimi, ose falimenton apo shkon në likuidim (ose, në secilin rast, ekuivalentin në secilin juridiksion); ose

xv. ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila e bën të pamundur realizimin e Projektit ose që Agjencia e Zbatimit të Projektit të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Me nxjerrjen e njoftimit për pezullim nga BERZH-i, në zbatim të pikës “a” më sipër, e drejta e Marrësit për të kërkuar Disbursime të tjera pezullohet ose anulohet, siç parashikohet në



njoftim. Ushtrimi nga BERZH-i i së drejtës së pezullimit nuk e pengon BERZH-in që të ushtrojë të drejtën e tij të anulimit, siç parashikohet në këtë seksion, qoftë për të njëjtën apo arsye tjetër, dhe nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Huas.

Seksioni 6.03 Rastet e Rimbursimit

a) Rastet dhe ndodhia e mëposhtme përbën një Rast të Rimbursimit sipas kësaj Marrëveshjeje:

i. ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë ndonjë nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve) dhe, nëse mund të rregullohet, kjo ngjarje ka vazhduar për një periudhë 30-ditore, pasi BERZH-i ka dhënë njoftim në lidhje me të;

b) Nëse një rast i Rimbursimit ndodh ose vazhdon të ndodhë, BERZH-i, nëpërmjet njoftimit të Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit, mund të kërkojë që Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Financimit me Grant dhe të paguajë çdo shumë tjetër të shkaktuar ose të pagueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje. Pavarësisht gjithçkaje në këtë Marrëveshje, shuma e kërkuar nga BERZH-i do të bëhet ose: i. e detyrueshme dhe e pagueshme me kërkesë me shkrim; ose ii. e detyrueshme dhe e pagueshme menjëherë pa ndonjë njoftim të mëtejshëm dhe pa ndonjë deklaratë, kërkesë apo kundërshtim të çfarëdo lloji, nga të cilat hiqet dorë shprehimisht nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit.

c) Pavarësisht gjithçkaje në këtë Marrëveshje, nëse BERZH-i, në çdo moment, konstaton mospërputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit ku Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit ose një Konsulent apo Kontraktues i përfshirë në Projekt është gjetur i përfshirë në një Praktikë të Ndaluar ose Shpagim gjatë konkurrimit ose ekzekutimit të një Kontrate, BERZH-i, nëpërmjet njoftimit të Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit, mund të kërkojë që Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Financimit me Grant dhe e njëjta pjesë të bëhet menjëherë e detyrueshme dhe e pagueshme me kërkesë.

Neni VII

Të ndryshme

Seksioni 7.01 Kushte dhe Zgjidhja

a) Kjo Marrëveshje bëhet e efektshme kur BERZH-i të marrë njoftim me shkrim nga Marrësi, ku konfirmohet se kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi pas miratimit nga autoritetet përkatëse shqiptare, dhe se të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar në lidhje me vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar. Në rast se ky njoftim nuk është marrë ose dorëzuar nga BERZH-i brenda 180 ditësh pas datës së kësaj Marrëveshjeje, kjo marrëveshje zgjidhet dhe nuk është në fuqi.

b) Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri kur Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, vetëm në rast kur është zgjidhur më herët në përputhje me kushtet e saj.

c) BERZH-i, Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit mundet, në diskrecionin e tij, të zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, por duke njoftuar me shkrim secilën nga Palët e tjera. Çdo njoftim i zgjidhjes nga BERZH-i, Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit, jo më vonë se 40 ditë.

d) Pas zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, sipas pikës “b” më sipër, Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit marrin hapa të menjëhershëm për të pakësuar humbjet dhe për të mbajtur në minimum shpenzimet sipas Kontratave.

Seksioni 7.02 Qëndrimi në Fuqi përtej Marrëveshjes

Deklaratat dhe garancitë e marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit (kur është e zbatueshme) dhe dispozitat e seksionit 2.03 (Disbursimet), seksionit 4.08 (Evidencat dhe Raportet Financiare), seksionit 4.09 (Dhënia e Informacionit), seksionit 4.12 (Inspektimi dhe Auditimi), seksionit 6.03(c) (Rastet e Rimbursimit), këtij seksioni 7.02 (Qëndrimi në Fuqi përtej Marrëveshjes), seksionit 7.05 (Gjuha Angleze), seksionit 7.07 (Përgjegjësia dhe Dëmshpërblimi), seksionit 7.09 (Legjislacioni Rregullues), seksionit 7.10 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve), seksionit 7.11 (Privilegjet dhe Imunitetet e BERZH-it) dhe seksionit 7.12 (Heqja Dorë nga Imuniteti Sovran) mbeten në fuqi për shlyerjen e Financimit me Grant dhe zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje.



Seksioni 7.03 Marrëveshja e plotë; Ndryshime dhe Heqja dorë

a) Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e referuara në këtë marrëveshje përbëjnë detyrimin e plotë të Palëve në lidhje me lëndën dhe zëvendëson çdo shprehje të mëparshme të qëllimit apo të kuptimeve (të shprehura apo të nënkuptuara me gojë ose me shkrim) në lidhje me këtë transaksion.

b) Çdo ndryshim i termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë këtë seksion 7.03) bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët. Palët mund të bien dakord që ta anulojnë ose ta ndryshojnë këtë Marrëveshje pa pëlqimin e ndonjë personi që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje.

c) Çdo heqje dorë nga ana e BERZH-it lidhur me ndonjë prej këtyre termave dhe kushteve, apo me pëlqimin e dhënë nga BERZH-i sipas kësaj Marrëveshjeje, bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga BERZH-i. Në rast se BERZH-i heq dorë nga një kusht për ndonjë Disbursim, atëherë, duke pranuar shumën e këtij Disbursimi, Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit konsiderohen që pajtohen me të gjitha termat dhe kushtet e kësaj heqje dorë.

Seksioni 7.04 Njoftimet

a) Çdo komunikimin administrativ i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje me BERZH-in, apo Marrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Programit, bëhet me shkrim dhe mund t'i dërgohet me postë elektronike Palës marrëse.

b) Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër joadministrativ i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje me BERZH-in, Marrësin apo Agjencinë e Zbatimit të Programit, bëhet me shkrim. Më përjashtim të sa parashikohet në këtë Marrëveshje, këto njoftime, kërkesa apo komunikime të tjera konsiderohen se janë dhënë apo bërë siç duhet kur i janë dorëzuar dorazi, ose me postë ajrore palës së cilës i kërkohet ose i lejohet t'i jepet ose t'i bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar më poshtë ose në një adresë tjetër, siç përcakton pala, duke njoftuar palën që jep ose bën një njoftim, aplikim apo komunikim tjetër.

Për Marrësin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3

Tirana
Albania

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për Agjencinë e Zbatimit të Programit:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10

Tirana

Albania

Në vëmendje të: Drejtorit Ekzekutiv

Email: adf@albaniandf.org

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Departamentit të

Administrimit të Operacioneve

Email: oad@ebrd.com

c) Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër joadministrativ i dhënë apo i bërë sipas kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi jepet apo bëhet nga përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit, sipas përkufizimit të këtij termi në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 7.05 Gjuha Angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe ekzekutuar në gjuhën angleze. Çdo dokument që nxirret dhe komunikimet që shkëmbehen sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen në gjuhën Angleze ose, në rast të përdorimit të një gjuhe tjetër, shoqërohen me përkthimin e noterizuar në gjuhën angleze nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit, sipas rastit. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje rreth gjuhës, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Seksioni 7.06 Të drejta, Mjete Juridike dhe Heqja dorë

a) Të drejtat dhe mjetet juridike të BERZH-it, në lidhje me ndonjë deklaratë të rreme ose shkelje të garancisë nga ana e Marrësit apo Agjencisë së Zbatimit të Programit, nuk do të cenohen nga asnjë hetim nga ose në emër të BERZH-it për çështjet e Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit, nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose nga ndonjë akt apo veprim tjetër që mund të bëhet nga ose në emër të BERZH-it në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që mund, përveç këtij



seksioni 7.06 (Të drejtat, Mjetet juridike dhe Heqja dorë), të cenojnë këto të drejta ose mjete juridike.

b) Asnjë mënyrë e trajtimit ose heqjes dorë nga ana e BERZH-it, në lidhje me ndonjë kusht të Disbursimit sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk dëmton asnjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me çdo kusht tjetër të Disbursimit ose të interpretohet se është një heqje dorë nga kjo.

c) Asnjë veprim i BERZH-it, për sa i përket ndonjë Disbursimi nuk mund të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it në lidhje me çdo Disbursim tjetër. Pa u kufizuar në sa më sipër, e drejta e BERZH-it për të kërkuar përputhshmëri me çdo kusht, sipas kësaj Marrëveshjeje që mund të hiqet dorë nga BERZH në lidhje me çdo Disbursim, përveç nëse njoftohet ndryshe për Marrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Programit nga BERZH, ruhet shprehimisht për qëllimet e çdo Disbursimi pasues.

d) Asnjë mënyrë e trajtimit dhe asnjë vonesë në ushtrim ose mosveprim për ushtrim të ndonjë të drejte, fuqie apo mjeti juridik që i akordohen BERZH-it pas ndodhjes së ndonjë Rasti të Rimbursimit ose, përndryshe sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të dëmtojë asnjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik, ose të interpretohet si heqje dorë nga kjo ose një pajtim me të. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, fuqie apo mjeti juridik nuk mund të pengojë ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij, ose ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie ose mjeti tjetër juridik. Asnjë veprim i BERZH-it në lidhje me ndonjë Rast të Rimbursimit nuk ndikon ose dëmton ndonjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të BERZH-it në lidhje me ndonjë Rast tjetër të Rimbursimit apo rasti tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive të të drejtave ose mjeteve të tjera juridike, pavarësisht nëse parashikohen nga ligji në fuqi apo ndryshe.

Seksioni 7.07 Përgjegjësia dhe Dëmshpërblimi

a) BERZH-i nuk jep asnjë deklaratë apo garanci dhe nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi në lidhje me Konsulentët, Kontraktuesit apo Zërat e Financuar nga Granti. Secila Palë:

i. pranon dhe bie dakord që nuk do të jetë përgjegjës ndaj tjetrit për asnjë përgjegjësi, detyrim, humbje, dëm (qoftë të drejtpërdrejtë, të tërthortë, financiar, ekonomik apo me pasoja, pavarësisht

nëse është shkaktuar ose jo nga veprimi i pakujdesshëm ose mosveprimi i BERZH-it), gjobë, pretendim, veprim, taksë, detyrim, padi, kosto dhe shpenzim (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e konsulencës ligjore apo kostot e hetimit), në lidhje me Konsulentët ose Kontraktuesit (duke përfshirë përzgjedhjen, angazhimin ose monitorimin e Konsulentëve apo Kontraktuesve) ose Zëri të Financuar nga Granti (duke përfshirë si pasojë e Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit, duke përdorur ose u mbështetur në shërbimet e Konsulentëve apo Kontraktuesve), ose që lind nga ose në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti; dhe

ii. liron dhe shkarkon palën tjetër nga çdo pretendim, të drejtë, borxh, përgjegjësi, kërkesë dhe veprim të çfarëdo lloji ose natyre, që mund të ketë tani apo në të ardhmen ndaj palës tjetër, që lind nga ose në lidhje me ndonjë veprim ose mosveprim të marrë ose bërë (ose që nuk është marrë ose bërë) nga Konsulentët apo Kontraktuesit në ofrimin e Zërave të Financuar nga Granti.

b) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit, dëmshpërblejnë bashkërisht dhe individualisht dhe do ta konsiderojnë BERZH-in të padëmshëm ndaj çdo veprimi, padie, pretendimi, kërkesë, humbje, tarife, dëmi, kostoje dhe shpenzimi, takse, gjobe, dhe detyrimi tjetër të shkaktuar dhe/ose pësuar nga BERZH-i, që rrjedh nga, prej ose në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti.

c) Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit shprehimisht pranojnë dhe bien dakord se BERZH-i nuk është i detyruar që të bëjë asnjë Disbursim apo ndonjë pagesë tjetër në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që fondet e mjaftueshme janë vënë në dispozicion nga Donatori për këtë qëllim.

Seksioni 7.08 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Dispozitat e seksionit 8.04 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) të Termave dhe Kushteve Standardë zbatohen si të përcaktuara këtu plotësisht *mutatis mutandis*, përveç:

a) referenca për “Marrëveshje Projekti” lexohet sikur të ishte referencë për “këtë Marrëveshje”; dhe

b) referenca për “Huamarrësin” lexohet sikur të ishte referencë për “Marrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Programit”.

Seksioni 7.09 Pasuesit dhe të Caktuarit ; Të Drejtat e Palëve të Treta

a) Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme



dhe e natyrshme në dobi të pasuesve dhe të caktuarve përkatës të Palëve, me përjashtim që, as Marrësi dhe as Agjencia e Zbatimit të Programit nuk mund të caktojnë ose transferojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave apo detyrimeve të tyre, sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin paraprak me shkrim të BERZH-it. Për të shmangur dyshimin, BERZH-i mund t'i caktojë Donatorit çdo pretendim që mund të ketë ndaj Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit, në lidhje me një shkelje të seksionit 6.02 (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve) apo ndonjë shumë të Financimit me Grant që është paguar në mënyrë të parregullt ose është përdorur në mënyrë të gabuar nga Agjencia e Zbatimit të Programit ose ndonjë Konsulent apo Kontraktues.

b) Me përjashtim të sa parashikohet në pikën “a” më sipër, asnjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk ka për qëllim të zbatohet nga palë të treta

Seksioni 7.10 Nxjerrja e të dhënave

a) BERZH-i mund të nxjerrë ato dokumente, informacione dhe evidenca që kanë lidhje me marrësin, Agjencinë e Zbatimit të Programit dhe këtë transaksion (duke përfshirë kopjet e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar këtu), që BERZH-i i gjykon të përshtatshme për çdo qëllim në lidhje me çdo mosmarrëveshje në lidhje me Projektin që përfshin Marrësin ose Agjencinë e Zbatimit të Programit, për qëllim të ruajtjes ose të zbatimit të ndonjë prej të drejtave të BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Marrëveshje, ose për qëllim të mbledhjes së shumës që i detyrohet BERZH-it.

b) BERZH mund t'i bëjë publike Donatorit dokumente, informacione dhe evidenca (duke përfshirë një kopje të kësaj Marrëveshjeje) të siguruar nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimi të Programit, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit, siç BERZH-i mund ta gjykojë të përshtatshme.

c) BERZH-i mund të publikojë një përshkrim të çdo Kontrate, duke përfshirë emrin dhe kombësinë e Konsulentëve ose Kontraktuesve dhe çmimin e kontratës.

Seksioni 7.11 Dublikatat

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në çdo dublikatë, ku secili konsiderohet origjinal, por ku të

gjitha së bashku përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të sa më sipër, palët e kësaj marrëveshjeje, me anë të përfaqësuesve të autorizuar posaçërisht prej tyre, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje dhe do të dorëzohet në dublikata në ditën dhe vitin e sipërpërmendur.

Për Marrësin

Nga: _____ Nënshkrimi _____

Emri: Anila Denaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Për Agjencinë e Zbatimit të Programit

Nga: _____ Nënshkrimi _____

Emri: Dritan Agolli

Titulli: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Nga: _____ Nënshkrimi _____

Emri: Jurgjen Rigtierink

Titulli: Në cilësinë e Presidentit

PASQYRA A
FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM
PËR KONTRATAT E KONSULENCËS

[Për t'u shtypur me letër me kokë të Agjencisë së
Zbatimit të Programit]

[datë]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Donor FundedOps
(donorinvoices@ebrd.com)

Për dëjani të: Laura Pedrejon
(pedrejol@ebrd.com)

Lënda: Nr. Veprimi 49351 (Komponenti i Grantit)

Kontratë Konsulencë nr. [numri i referencës]

Kontratë Konsulencë nr. [numri i referencës]

Kërkesë Disbursimi nr. _____¹

¹ Secila kërkesë duhet të numërohet në seri.



I/e nderuar,

1. Ju lutemi referojuni marrëveshjes së grantit, datë [] (Marrëveshja e Grantit) lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Programit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Grantit kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë dokument.

²3. Ne kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit:

i. Donatori: Bashkimi Evropian

Monedha e pagesës së kërkuar: EUR

Shuma totale (në shifra dhe fjalë): _____

Data e Vlerës: [Sa më shpejt që të jetë e mundur, në një datë të zgjedhur nga BERZH-i, në diskrecionin e tij, por jo më vonë se]³ _____⁴.

⁵4. Lidhur me shumën prej [] për disbursim nga llogaria e Donatorit, ne konfirmojmë deklaratimet e dhëna në aneksin A (Kontratë Konsulencë nr. [numri i referencës]) për këtë Kërkesë Disbursimi.

5. Lidhur me shumën prej [] për disbursim nga llogaria e Donatorit, ne konfirmojmë deklaratimet e dhëna në aneksin B (Kontratë Konsulencë nr. [numri i referencës]) për këtë Kërkesë Disbursimi.

6. Për qëllime të seksionit 3.03 (Të gjitha Disbursimet e Financimit me Grant) të Marrëveshjes së Grantit, ne deklarojmë dhe garantojmë se:⁶

a) deklaratat dhe garancitë e dhëna ose konfirmuara nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit në këtë Marrëveshje janë të vërteta dhe të sakta në datën e kësaj dite me të njëjtin efekt sikur të ishin bërë deklaratat dhe garanci të tilla në datën e këtij dokumenti;

b) nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon asnjë Rast i Rimbursimit;

c) nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë një

efekt material negativ për Marrësin apo Agjencinë e Zbatimit të Programit apo Projektit; dhe

d) Kontrata e Konsulencës është në efekt dhe fuqi të plotë dhe nuk ka pësuar asnjë ndryshim përmbajtësor.

⁷7. Bashkëlidhur kësaj Kërkesë Disbursimi gjendet:

⁸a) një kopje e noterizuar e një fature, datë [] nga [emri i Konsulentit] në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse⁹] në lidhje me Disbursimin që kërkohet nga llogaria e Donatorit;

b) një kopje e noterizuar e një fature, datë [] nga [emri i Konsulentit] në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse] në lidhje me Disbursimin që kërkohet nga llogaria e Donatorit;

c) dokumente të tjera që ka kërkuar BERZH-i [duke përfshirë: i. dëshmi lidhur me përdorimin e propozuar të të ardhurave të Disbursimit; dhe ii. dëshmi lidhur me përdorimin e të ardhurave nga ndonjë Disbursim/e) i mëparshëm].

8. Më lëshimin e kësaj Kërkesë Disbursimi, Agjencia e Zbatimit të Programit autorizojnë BERZH-in që të kryejë Disbursimin si më poshtë:

i. për [emri i Konsulentit], në zbatim të Kontratës së Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga llogaria e Donatorit;

ii. për [emri i Konsulentit], në zbatim të Kontratës së Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga llogaria e Donatorit.]

Në emër të Marrësit.

Me respekt,

NËNSHKRUES I AUTORIZUAR
NË EMËR TË MARRËSIT

Nga: _____

⁷Zërat e mëposhtëm duhet të pasojnë pikat përkatëse në seksionin 3.02.

⁸ Nëse Zërat e Financuar nga Granti prokurohen **në tregun me pakicë** (apo të barasvlershëm me të), nuk kërkohen fatura të Kontratës. Por, Përfituesi siguron dëshminë e blerjes dhe pagesës për këta zëra.

⁹ Nuk kërkohen dokumente mbështetëse për Zërat e Financuara nga Granti, të cilat **financohen në bazë të një shume të vetme**, ku Përfituesi i nënshtrohet ruajtjes së evidencave të pagesave dhe dokumenteve mbështetëse, siç kërkohet nga kjo Marrëveshje.

² Përfshini shumën totale për disbursim nga Donatori.

³ Nëse pagesa kërkohet për një datë specifike të vlerës, fshini këtë gjuhë të vendosur në kllapa.

⁴ Kjo datë nuk mund të jetë më herët se 10 Ditë Pune, pasi Kërkesa e Pagesës të dorëzohet pranë BERZH-it.

⁵ Përsëritni pikën 4 për secilën Kontratë dhe Kontratë Konsulencë.

⁶ Zërat e mëposhtëm duhet të pasojnë pikat përkatëse në seksionin 3.02.



Përfaqësuesi i Autorizuar¹⁰

¹¹ ANEKSI A: Kontratë Konsulence nr. [numri i referencës]

Lidhur me shumën prej [vendosni shumën] për disbursim nga llogaria e Donatorit, ne konfirmojmë se:

¹²(a) Të ardhurat nga Disbursimi i nevojiten Marrësit në mënyrë rigorozë edhe vetëm për financimin e kostove të kërkuara të shpenzimeve të kryera [ose, nëse është rënë dakord me BERZH-in, që do të kryhen] në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti të përshkruara në pjesën [] të Skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti).

b) Ne ju keni paraqitur një kopje të noterizuar të Kontratës së ekzekutuar të Konsulencës për [titulli i kontratës] datë [] dhe lidhur ndërmjet [Agjencisë së Zbatimit të Programit dhe [emri i Konsulentit], me numër reference [].

c) Shuma prej [] do të përdoret si më poshtë: [Marrësi duhet të hedhë detajet e përdorimit të propozuar të të ardhurave nga Disbursimi].

d) Shërbimet e Konsulencës janë kryer me sukses në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse të Konsulencës.

e) Fatura e bashkëlidhur është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumat e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës me numër reference [].

f) Udhëzimet e pagesës për Konsulentin:

i. Të dhënat e bankës së Konsulentit:

Emri i llogarisë së Konsulentit: _____

Numri i llogarisë së Konsulentit (numri IBAN)¹³: _____

Emri i bankës së Konsulentit: _____

Kodi SWIFT i bankës së Konsulentit _____

Adresa e bankës së Konsulentit: _____

ii. Të dhënat e bankës korresponduese të Konsulentit:

Emri i bankës korresponduese:¹⁴ _____

Kodi SWIFT i bankës korresponduese: _____

Adresa e bankës korresponduese: _____

Emri i llogarisë së bankës korresponduese:

Numri i llogarisë së bankës korresponduese (numri IBAN)¹⁵: _____

Referencë: _____

¹⁶[g] Vërtetojmë se kemi paguar një shumë të barabartë me të gjitha taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) për të gjitha faturat e mëparshme të secilit prej Konsulentëve, dhe me këtë marrim përsipër të paguajmë taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në faturën në të cilën kjo Kërkesë Disbursimi lidhet brenda [30 ditëve] nga data e kësaj Kërkesë Disbursimi.

PASQYRA B
FORMULARI I KËRKESËS SË DISBURSIMIT
PËR KONTRATA MALLRASH, PUNIMESH
DHE SHËRBIMESH

[Për t'u shtypur me letër me kokë të Marrësit/Nënshkruesit të Autorizuar të Marrësit]

[Data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operimeve

¹⁰ Emri i personit që nënshkruan Kërkesën e Pagesës duhet të vendoset në Shkresën e Caktimit të Nënshkruesve të Autorizuar.

¹¹ Përfshini një aneks për çdo Kontratë Konsulence.

¹² Kjo fjalë duhet të pasojë formulimin e Seksionit 2.02 (Pagesat).

¹³ Të gjitha pagesat që nuk kryhen në dollarë amerikanë duhet të përfshijnë numrin e plotë IBAN (numri ndërkombëtar i llogarisë bankare).

¹⁴ Emri i bankës në Londër.

¹⁵ Të gjitha pagesat që nuk kryhen në dollarë amerikanë duhet të përfshijnë numrin e plotë IBAN (numri ndërkombëtar i llogarisë bankare).

¹⁶ Përfshini nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e pagueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës (shihni seksionin 2.04 (c) (Taksat dhe Detyrimet)).



Nr. veprimi 49351 (Komponenti i Grantit)
Kërkesë Disbursimi nr. [1]

Referencë: Marrëveshja e Grantit, datë [_____] e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Programit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

Ne kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit të përmendura më sipër:

Monedha e Grantit: EURO

Monedha e pagesës së kërkuar: [2]

Shuma/t e financuar/monedha: [3]

Data e vlerës: [4]

Të pagueshme për (Marrësin e pagesës): [5]

Emri i llogarisë të Marrësit: [6]

Numri i llogarisë të Marrësit: [7]

Emri i bankës së Marrësit: [8]

Adresa e bankës së Marrësit: [9]

Të dhënat e Bankës Korresponduese të Marrësit të Pagesës:

Emri i Bankës Korresponduese: [10]

Adresa: [11]

Emri i llogarisë: [12]

Numri i llogarisë: [13]

Referenca e pagesës: [14]

Adresa e postës elektronike të Marrësit të Pagesës: [15]

Me anë të kësaj, vërtetojmë se nuk kemi kërkuar më parë asnjë disbursim nga Financimi me Grantit për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Ne nuk kemi marrë dhe as nuk synojmë të marrim fonde për këtë qëllim nga asnjë burim tjetër i ndonjë granti, kredie apo huaje.

Mallrat dhe shërbimet që mbulohen nga kjo kërkesë janë blerë ose po blihen në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Grantit.

Për qëllime të seksionit 3.03 (Të gjitha Disbursimet e Financimit me Grant) të Marrëveshjes së Grantit, ne deklarojmë dhe garantojmë, se:

a) Marrëveshja e Huas është në efekt dhe fuqi të plotë dhe se Marrësi është në përputhje me të gjitha detyrimet e tij në cilësinë e tij si huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas;

b) deklaratat dhe garancitë e dhëna apo të konfirmuara nga Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit në Marrëveshjen e Grantit janë të vërteta dhe me të njëjtin efekt që këto deklaratat dhe garanci janë kryer sipas datës së këtij dokumenti;

c) nuk ka ndodhur ose nuk vazhdon të ndodhë asnjë nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02 (a) (Pezullimi ose Anulimi i Disbursimeve) të Marrëveshjes së Grantit;

d) Agjencia e Zbatimit të Programit nuk do të jetë, si rezultat i një Disbursimi të tillë, në shkellje të Statutit të e saj, ndonjë dispozitë që parashikohet në çdo marrëveshje apo instrument në të cilin Agjencia e Zbatimit të Programit është palë (duke përfshirë Marrëveshjen e Grantit) ose me të cilën Agjencia e Zbatimit të Programit është e lidhur ose ndonjë ligj i zbatueshëm për Agjencinë e Zbatimit të Programit;

e) nuk ka ndodhur asgjë që, sipas mendimit të arsyeshëm të BERZH-it, mund të ketë një efekt negativ material për Marrësin, Agjencinë e Zbatimit të Programit ose Projektin;

f) [në lidhje me Mallrat, Punimet dhe Shërbimet për t'u financuar sipas pjesës 3, të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti) të Marrëveshjes së Grantit] BERZH-i ka pranuar një kërkesë ose paraprake dhe të kënaqshme për tërheqjen, sipas Marrëveshjes së Huas, si: vlera e kontratës e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve që do të financohen në kuadër të pjesës 3, të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti) nuk kalojnë 20 (njëzet) për qind të shpenzimeve të agreguara;

g) një kopje e noterizuar është siguruar për secilën Kontratë të ekzekutuar dhe secilën faturë në lidhje me të cilën kërkohet Disbursimi;

h) Marrësi konfirmon se:

i. Zërat e Financuar nga Granti janë siguruar në mënyrë të kënaqshme ose janë kryer në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Grantit dhe Kontratës përkatëse; dhe

ii. çdo faturë është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumat e përcaktuara në Kontratën përkatëse; dhe

BERZH-i ka marrë dokumente të tjera, siç BERZH-i mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë: i. dëshmi në lidhje me



përdorimin e propozuar të të ardhurave të Disbursimit; dhe ii. dëshmi të përdorimit të të ardhurave të çdo Disbursimi paraprak.

Ne i konfirmojmë BERZH-it, që: i. jemi në përputhje me detyrimet tona, siç përcaktohen në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshjen e Huas; dhe ii. që nuk ka ndodhur ndonjë rast që mund të prekë ndjeshëm dhe negativisht veprimtaritë tona ose gjendjen financiare ose aftësinë tonë për të realizuar projektin, apo për të përmbushur ndonjë nga detyrimet tona, sipas Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt,

NËNSHKRUES I AUTORIZUAR
NË EMËR TË MARRËSIT

Nga: _____

Emri:

Titulli: [Përfaqësuesi i Autorizuar] [16]

Materialet e bashkëlidhura: - Numri total i fletëve përmbledhëse: [17]

- Numri total i zërave të dokumenteve: [18]

Shënime për plotësimin e formularit të Kërkesës për Disbursim

[1] Marrësit duhet të numërtojë secilin formular kërkesë. Kërkesa e parë për një disbursim të grantit do të jetë numri 1, kërkesat pasuese do të numërtohen 2, 3 etj. I takon Agjencisë së Zbatimit të Programit të mbajnë shënimet e numrit të të gjitha kërkesave për disbursim të grantit, që kanë kryer sipas Marrëveshjes së Grantit. Formularët e kërkesës duhet të ndjekin të njëjtën sistem renditjeje numërtimi, pavarësisht nëse ato janë për një disbursim të drejtpërdrejtë pagesë, ose për lëshimin e një angazhimi rimbursimi. Përdorimi i këtij sistemi numërtimi shmang konfuzionin në rastet kur formularët vonohen në postë, transmetohen me faks më shumë se një herë etj.

[2] Shuma/t e financiar janë shpenzimet origjinale, në monedhën e tyre origjinale, siç detajohet në fletën përmbledhëse, të llogaritura në përqindjen e duhur të specifikuar në marrëveshjen e grantit për Zërat e Financiar nga Granti. Shuma/t e dhënë/a këtu duhet të korrespondojë me shumën/at totale në pikën [15] të fletës përmbledhëse.

[3] Data e vlerës është data kur llogaria e BERZH-it debitohet me shumën e pagesës së disbursimit. BERZH-i nuk mund të garantojë që llogaria e marrësit të pagesës do të kreditohet në të njëjtën datë, pasi kjo varet nga procedurat e miratuara nga sistemi i mbylljes së transaksionit ose nga banka marrëse në vendin e marrësit të pagesës. Duhet të ketë minimumi 15 ditë pune ndërmjet datës që BERZH-i merr kërkesën dhe datës së vlerës së kërkuar. Nëse në të vërtetë pagesa nevojitet sa më shpejt të jetë e mundur, në vend të datës specifike të vlerës, mund të jetë më mirë të mos jepni një datë specifike, por të vendosni “sa më shpejt të jetë e mundur” në këtë fushë [4]. Në këtë rast, BERZH-i do të bëjë pagesën në çdo rast brenda 15 ditëve të punës, por edhe më herët nëse është e mundur. (Ju lutem vini re se pagesa mund të garantohej vetëm brenda 15 ditëve të punës, nëse kërkesa për disbursim është e saktë dhe e plotë.)

[4] Disbursimi i paguhet marrësit të pagesës. Normalisht, marrësi i pagesës do të jetë Kontraktuesi, por me kusht që Banka të ketë rënë dakord ndryshe me shkrim dhe që dokumentacioni i bashkëlidhur (shihni fletën përmbledhëse) të sigurojë dëshmi se huamarrësi e ka paguar tashmë Kontraktuesin, atëherë pagesa mund t'i bëhet Marrësit.

[5] Emri i llogarisë së marrësit të pagesës, në shumicën e rasteve, thjesht do të jetë emri i marrësit të pagesës.

[6] Numri i llogarisë së marrësit të pagesës është i detyrueshëm për të shmangur vonesat. Në një numër të madh vendesh, bankat do të refuzojnë të kryejnë pagesa nëse numri i llogarisë së marrësit nuk është dhënë në udhëzimet e pagesës.

[7] Banka e marrësit të pagesës është banka ku mbahet llogaria e marrësit. Ju lutemi tregoni emrin e bankës dhe qytetin.

[8] Në vend të adresës mund të jepet kodi i klasifikimit ose kodi SWIFT.

[9] Banka korresponduese e bankës së marrësit të pagesës kërkohet vetëm nëse pagesa nuk do të bëhet në monedhën e vendit ku ndodhet banka e marrësit. Në atë rast, banka korresponduese është banka, që ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, ku banka e marrësit të pagesës ka një llogari.



[10] Në vend të një adrese, mund të jepet kodi i klasifikimit ose kodi SWIFT i bankës korresponduese.

[11] Emri i llogarisë së bankës së marrësit të pagesës, në shumicën e rasteve, thjesht do të jetë emri i bankës së marrësit.

[12] Numri i llogarisë së bankës së marrësit të pagesës është thelbësor, nëse banka e marrësi mban më shumë se një llogari në bankën korresponduese, ose nëse nuk është anëtar i SWIFT-it (sistemi ndërkombëtar elektronik i shlyerjes së pagesave). Përndryshe, ky numër është i dobishëm, por jo i detyrueshëm. Sipas rastit, duhet të citohet numri IBAN (Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare).

[13] Referenca e pagesës që BERZH-i do të dërgojë me pagesën e ndihmon marrësin që të identifikojë pagesën. Nëse nuk kërkohet ndonjë referencë specifike, BERZH-i do të përmendë emrat e Agjencisë e Zbatimit të Programit dhe numrin e marrëveshjes.

[14] Adresa e postës elektronike të marrësit të pagesës kërkohet në mënyrë që Banka të dërgojë njoftime për pagesa të ardhshme të marrësi përpara se Banka t'i bëjë këto pagesa. Ajo duhet të jetë një adresë e postës elektronike që marrësi e kontrollon rregullisht.

[15] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkesës duhet të nënshkruhet nga ose në emër të Marrësit.

[16] Fletët përmbledhëse rendisin të gjitha zërat e dokumentacionit të bashkëlidhur për të mbështetur aplikimin e kërkesës për Disbursim. Nëse ka shumë zëra, këshillohet të përdorni një fletë përmbledhëse të veçantë për kategori.

[17] Zërat e dokumentacionit (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të numërtohen dhe vendosen në të njëjtën radhë, siç paraqiten në fletët përmbledhëse. Numri i tyre i përgjithshëm duhet të tregohet këtu për të lehtësuar shqyrtimin e BERZH-it.



Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Emri i Marrësit: [1]

Veprimi
Nr.: [3]Kërkesa
Nr.: [4]

Data: [2]

Fleta përmbledhëse
nr.: [5]Disbursimi
Zëri i Financuar
nga Granti: [6] (nr. ref./emri/ %)
...../...../.....

Nr. i Zërit	Përshkrimi	Nr. dhe data e Kontratës	Emri dhe Adresa e Kontraktuesit	Përshkrim i shkurtër i Mallrave, Punimeve ose Shërbimet e shpenzimeve	Monedha dhe Shuma Totale e Kontratës	Monedha dhe Shuma e Shpenzimeve të Pranueshme	Shuma e Financimit në monedhën e shpenzimeve
[7]	[8]	[9]	[10]	[11]	[12]	[13]	[14]

Nënshkrimi:

[16]

TOTALI (për monedhë)

[15]



SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËS PËRMBLEDHËSE TË KËRKESËS PËR DISBURSIM

[1] Emri. Emri i Marrësit. Kjo duhet të jetë e njëjtë me atë në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[2] Data. Data e kërkesës. Kjo duhet të jetë e njëjtë me atë në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[3] Numri i Veprimit. Ky numër duhet të jetë i njëjtë me atë në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[4] Numri i kërkesës. Ky është numri i kërkesës për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[5] Numri i fletës përmbledhëse. Për çdo kërkesë Disbursimi, fletët përmbledhëse duhet të numërtohen, duke filluar nga numri 1 dhe numri total i shënuar në Kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[6] Zërat e Disbursimit që Financohen nga Granti. Ky është Zëri i Financuar nga Granti për projektin, për t'u financuar nga të ardhurat e Disbursimit të kërkuar. Ju lutem konsultohuni me Marrëveshjen e Grantit për të gjetur emrin dhe numrin e referencës së Zërave të Financuar nga Granti, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen (për shembull “Zëri i Financuar nga Granti nr. (3b), pajisje, 60%”). Nëse një Kërkesë për Disbursim mbulon shpenzimet e më shumë se një Zëri të Financuar nga Granti, atëherë duhet të përdoret më shumë se një fletë përmbledhëse për çdo Zë të Financuar nga Granti.

[7] Numri i zërit. Të gjitha zërat e dokumenteve (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të paraqiten në të njëjtin rend, siç tregohet në fletën përmbledhëse. Për të lehtësuar identifikimin, dokumentet duhet të numërtohen, duke filluar me 1, 2, 3 etj., për çdo kërkesë të re Disbursimi dhe ky numër duhet të shënohet qartë në vetë dokumentin. Numri total i zërave për numrin total të të gjitha fletëve përmbledhëse është shënuar në formularin e kërkesës për Disbursim.

[8] Përshkrimi i zërit. Ju lutemi përshkruani çdo zë, si për shembull “faturë”, “dëftesë”, “certifikatë inxhinieri”, “përkthim i [...]” etj.

[9] Numri rendor dhe data e Kontratës. Rekomandohet që kontratës t'i vendoset një numër i veçantë kur ajo të hartohet dhe nënshkruhet ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe

Kontraktuesit. BERZH-i do të përdorë këtë numër për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave të veta. Nëse kontratës nuk i është vënë një numër i veçantë, BERZH-i do të vendosë një numër dhe do të informojë Agjencinë e Zbatimit të Programit në kohën e miratimit. Nëse Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit nuk e di numrin në kohën e plotësimit të fletës përmbledhëse, kjo pjesë do t'i lihet BERZH-it për plotësim.

Data e Kontratës/e urdhrit të blerjes duhet, gjithashtu, të vendoset në këtë kolonë.

Shënim. E njëjta kontratë mund të paraqitet në më shumë se një kërkesë për Disbursim, nëse livrimi i mallrave, pagesa e punimeve ose shërbimeve (shihni pikën [11]) dhe, rrjedhimisht, pagesa për këto mallra etj., bëhet në fazë.

[10] Emri dhe adresa e Kontraktuesit. Emri dhe adresa e kundërpalës (Kontraktuesit), sipas kontratës/urdhrit të blerjes, siç përshkruhet në pikën [9].

[11] Përshkrim i shkurtër i mallrave, punimeve ose shërbimeve. Këto mallra, punime ose shërbime duhet të jenë në përputhje me hollësitë e dhëna në Kontratë ose në dokumente të tjera që paraqiten dhe duhet të jenë, sipas Zërave të Financuar nga Granti, të përcaktuara në pikën [6].

[12] Monedha dhe vlera totale e Kontratës. Vlera e plotë, në monedhën përkatëse, e Kontratës e renditur në pikën [9].

[13] Monedha dhe vlera totale e shpenzimeve të pranueshme. Për shpenzime: vlera totale e cila përbën detyrim ose duhet paguar, në monedhën përkatëse, e mbuluar nga faturat dhe dokumentet të tjera të renditura në pikat [7] dhe [8]. Kur ka më shumë se një “zë” për secilin shpenzim (për shembull një faturë, certifikatë ose dëftesë, që të gjitha për të njëjtin shpenzim), të gjithë këta zëra duhet të futen në kllapa dhe në kolonën përkatëse duhet të vendoset vetëm një shumë.

[14] Shuma e financimit. Për çdo shumë të renditur në kolonën [13] duhet të jepet një shumë korresponduese në këtë kolonë [14], e llogaritur në bazë përqindjeje sipas deklaramit në [6], që korrespondon me kategorinë e kësaj flete përmbledhëse. Shuma e financimit duhet të jetë në monedhën përkatëse të kontratës dhe shpenzimeve (kolonat 12 dhe 13). Kjo mund të jetë ose mund të mos jetë e njëjtë me monedhën e huas ose monedhën e pagesës.



[15] Totali. Shumat e financimit, sipas renditjes së pikës [14], duhet të mbledhen për të arritur në një shumë totale në monedhën e caktuar. Për kërkesat e drejtpërdrejta për Disbursim, shuma/t totale të paraqitura këtu duhet të jetë/jenë në përputhje me shumën/at e paraqitura në pikën [9] të Formularit të Kërkesës për Disbursim.

[16] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkuar duhet të nënshkruhet nga dhe në emër të Marrësit. Shihni formularin e Kërkesës për Disbursim në lidhje me kërkesat për nënshkrim.

PASQYRA C
FORMULARI I SHKRESËS QË CAKTON
NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

[Për t'u shtypur me letër me kokë të Marrësit]

[datë]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamentit të
Administrimit të Operacioneve
Nr. faksi : +442073387017

Lënda: Marrëveshja e Grantit nr. 49351
Shkresa e Caktimit të Nënshkruesve të
Autorizuar

I/e nderuar,

Referuar Marrëveshjes së Grantit të datës 8 tetor 2020 (Marrëveshja e Grantit) ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Programit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ju lutemi, informohuni se nga personat për të cilët më poshtë jepet modeli i nënshkrimit të tyre, janë të autorizuar në emër të Përfutjesit që të nënshkruajnë [Kërkesat për Disbursim dhe [çdo lloj [tjetër] njoftimi ose dokumenti] të kërkuar ose të lejuar për ekzekutim, sipas Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër.

EMRI POZICIONI/SUBJEKTI MODELI
I NËNSHKRIMIT

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

[Të gjitha njoftimet e mëparshme që jepnin nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar në emër të Marrësit, sipas Marrëveshjes së mësipërme të Grantit konsiderohen të revokuara.]

Me respekt,

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

Shënime për plotësimin e shkresës për caktimin e nënshkruesve të autorizuar

- Autorizimi i mësipërm duhet nënshkruar në emër të Marrësit nga Përfaqësuesi përkatës i Autorizuar. [Ju lutemi, vini re se, në lidhje me ndonjë veprim të kërkuar ose të lejuar, sipas dispozitave të seksionit 2.02 ose 2.03 të Marrëveshjes së Grantit, autorizimi i mësipërm duhet të nënshkruhet në emër të Marrësit nga Përfaqësuesi i tij i Autorizuar.]

- Në rast se secili dokument duhet të nënshkruhet nga më shumë se një nëpunës, shkresa e autorizimit duhet ta theksojë këtë qartë dhe fjalia e parë duhet të përshtatet siç duhet.

Nëse nënshkruesit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i një nëpunësi nga secili grup, edhe ky fakt duhet të shprehet qartë.



SKEDULI 1 ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI

Zërat e Financuar nga Granti që do të menaxhohen nga Marrësi (përmes Agjencisë së Zbatimit të Programit) përfshijnë si më poshtë:

Zëri i Financuar nga Granti	Përshkrimi i Zërave të Financuara nga Granti	Deri në Shumën	Monedha
Pjesa 1			
A. Shërbime Konsulence	Programe Gjimore dhe Gjithëpërfshirje (TCRS 73734)	980,000.00	EUR
B. Shërbime Konsulence	Model me drejtim në turizëm për Zhvillimin Ekonomik Vendës (TCRS 69028)	2,000,000.00	EUR
Pjesa 2			
A. Shërbime Konsulence	Përgatitja e Projektit, Zbatimi i Projektit (TCRS 73733)	6,215,000.00	EUR
B. Mallra, Punime dhe Shërbime	Rehabilitimi i Siteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore	8,500,000.00	EUR
Pjesa 3			
Mallra, Punime dhe Shërbime	Ndërtimi i Infrastrukturës së Bashkisë dhe Transportit	15,635,000.00	EUR
Totali		33,330,000.00	EUR

* Shumat e parashtruara në këtë skedul janë përlogaritur sipas buxhetit indikativ në Marrëveshjen e Kontributit.

SKEDULI 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTT

1. Qëllimi i Projektit është të krijojë një program investimi për të përmirësuar konkurrueshmërinë e Shqipërisë, duke financuar:

- Infrastrukturën për zhvillimin e turizmit në bashkitë e Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës (krahas restaurimit, përmirësimit dhe/ose zhvillimit të siteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që do të financohen vetëm nëpërmjet Financimit nga Granti) (Komponenti A); dhe

- Investimet e përgjithshme në Infrastrukturën e bashkisë dhe transportit (Komponenti B) në të gjithë territorin e Huamarrësit.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat u nënshtrohen ndryshimeve që mund të dakordësohen ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, sipas rastit:

Pjesa 1 – Asistenca teknike për turizmin (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Paketa turistike;
- Këshilla për biznesin e vogël;
- Trajtime për përfshirjen gjimore dhe ekonomike.

Pjesa 2 – Rehabilitimi i siteve kulturore dhe natyrore (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Asistencë teknike (përgatitja, zbatimi dhe mbikëqyrja e projektit);

- Grante investimi (Nënprojekte për sitet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit A);

Pjesa 3 – Ndërtimi i infrastrukturës bashkiake dhe të transportit (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti dhe shumës së Huas):

- Asistencë teknike (përgatitja, zbatimi dhe mbikëqyrja e projektit);

- Grante investimi (Nënprojekte infrastrukturore që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit dhe A dhe Komponentit B);

- Huaja e BERZH-it (Nënprojekte infrastrukturore që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit dhe A dhe Komponentit B);

Pjesa 4 – Instrumenti i ndarjes së riskut – Institucione Financiare (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Incentiva investimi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme



- Asistencë teknike

3. Nënprojekte për t'u financuar sipas pjesëve 2 dhe 3 më sipër (përdorimi i shumës së Huas dhe/ose Financimit nga Granti) zbatohet për Komponentin A dhe Komponentin B të Projektit si më poshtë:

Komponenti A përfshin:

i. site të trashëgimisë kulturore që do të financohen vetëm nëpërmjet Financimit nga Granti; dhe

ii. Nënprojekte për Infrastrukturën për t'u financuar nga shuma e Huas dhe/ose Financimit nga Granti.

Komponenti B përbëhet nga:

i. Nënprojekte për Infrastrukturën për t'u financuar nga shuma e Huas dhe/ose Financimit nga Granti.

Secili Nënprojekt duhet të përmbushë Kriteret e Pranueshmërisë të përcaktuara në skedulin 6. Secili Nënprojekt që do të financohet plotësisht ose pjesërisht nga të ardhurat nga Huaja, duhet që fillimisht të konsiderohet si pjesë e përkufizimit të Infrastrukturës, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas.

Nënprojektet e përcaktuara treguese do të zbatohen në përputhje me Planin e Prokurimit.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2025.

SKEDULI 3

TERMA DHE KUSHTE TË KONTRATËS

Agjencia e Zbatimit të Programit siguron që çdo Kontratë të përfshijë dispozitat e mëposhtme:

- duke kërkuar që çdo Konsulent ose Kontraktues dhe secili nënkontraktues përkatës të mos përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndalar;

- duke kërkuar që secili Konsulent ose Kontraktues dhe secili prej nënkontraktuesve të tyre përkatës të mbajnë dokumente dhe evidenca të kontabilitetit financiar, në lidhje me aktivitetet e financuara nga Granti për jo më pak se 5 vjet pas këtij të fundit:

i. datës në të cilën Granti do të jetë disbursuar plotësisht;

ii. datës së fundit për disbursimin e Grantit; dhe

iii. nëse një auditim ose hetim është ndërmarrë nga Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF) ose nga BERZH-i, në lidhje me Projektin, datës kur një auditim ose hetim i tillë ka përfunduar,

dhe i vë këto evidenca në dispozicion të përfaqësuesve të BERZH-it me kërkesë të BERZH-it;

- duke kërkuar që secili Konsulent ose Kontraktues dhe secili nga nënkontraktuesit e tyre përkatës të:

i. frenohet nga çdo veprimtari që mund të cenojë ushtrimin e paanshëm dhe objektiv të funksioneve të çdo personi që përmbush detyrimet e tij sipas Kontratës;

ii. ruajë ekzistencën e korporatës së tij në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe të zhvillojë biznesin e tij me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në përputhje me praktikën më të mira të inxhinierisë, financës dhe biznesit, dhe në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, duke përfshirë të gjitha ligjet në lidhje me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit; dhe

iii. sigurojë mbrojtjen e duhur të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi;

- duke kërkuar që çdo Konsulent ose Kontraktues dhe secili prej nënkontraktuesve të tyre përkatës t'i sigurojë menjëherë këto informacione Agjencisë së Zbatimit të Programit, kur kjo e fundit mund të kërkojë herë pas herë në mënyrë të arsyeshme;

- duke kërkuar nga secili Konsulent ose Kontraktues dhe secili prej nënkontraktuesve të tyre përkatës të lejojnë BERZH-in dhe/ose Komisionin Evropian, OLAF-in, Gjykatën Evropiane të Audituesve ose ndonjë prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar të kryejnë shqyrtime dokumentacioni dhe kontrole në vend lidhur me përdorimin e kontributit të Donatorit. Për këtë qëllim, Agjencia e Zbatimit të Programit i kërkon secilit Konsulent ose Kontraktuesi dhe secilit prej nënkontraktuesve të tyre përkatës t'i mundësojnë BERZH-it dhe/ose Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve ose ndonjë prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar, sipas kërkesës:

i. të vizitojnë çdo objekt, kantier ndërtimi dhe ambient lidhur me Projektin;

ii. të kenë akses dhe të kontrollojnë çdo mall, punim dhe shërbim të financuar nga të ardhurat e Grantit;

iii. të kenë akses dhe të inspektojnë çdo llogari, evidencë, dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara të Konsulentit apo të Kontraktuesit dhe



secilit prej nënkontraktuesve të tyre përkatës të lidhur me Projektin, dhe të lejojmë që këto evidenca dhe llogari të auditohen nga BERZH-i ose përfaqësuesit e tij.

- duke kërkuar që secili Konsulent ose Kontraktues dhe secili prej nënkontraktuesve të tyre përkatës të lejojnë BERZH-in t'i bëjë publike Donatorit dokumente, informacione dhe evidenca (duke përfshirë një kopje të Kontratës), në lidhje me Projektin ose Grantin, siç BERZH-i do ta gjykojë të përshtatshme.

- duke kërkuar që secili Konsulent ose Kontraktues dhe secili prej nënkontraktuesve të tyre përkatës të marrë masat e duhura për të bërë publike faktin që Projekti ka marrë fonde nga Donatori dhe në veçanti për të siguruar, që:

i. informacionet e dhëna për medien, si dhe të gjitha materialet promocionale, njoftimet zyrtare, raportet dhe publikimet, të njohin faktin se Projekti është realizuar “me financim nga Bashkimi Evropian” dhe të përmbajnë logon e BE-së (dymbëdhjetë yje të verdha në një sfond blu) në një mënyrë të përshtatshme;

ii. publikimet lidhur me Projektin (duke përfshirë publikimet elektronike) të mbajnë mospranimin e përgjegjësisë si në vijim: Ky dokument është përgatitur me asistencën financiare të Bashkimit Evropian. Këndvështrimet e

shprehura në këtë dokument nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian; dhe

iii. nëse pajisjet, mjetet ose furnizimet e mëdha blihen me fondet e BE-së, të shfaqet dëftesa e duhur (duke përfshirë logon e BE-së) në këto mjete, pajisje dhe furnizime të mëdha (përveç nëse kjo mund të cenojë sigurinë e stafit të Përfituesit).

- duke lejuar Agjencinë e Zbatimit të Programit, me njoftim me shkrim për Konsulentin ose Kontraktues, të pezullojë ose anulojë të drejtën e Konsulentit ose Kontraktues për të kërkuar të gjithë ose ndonjë pjesë të ndonjë pjese të padisbursuar të Grantit nëse ndonjë shumë e Grantit i është paguar padrejtësisht ose përdorur nga Konsulenti ose Kontraktuesi (ose ndonjë prej nënkontraktuesve të tyre përkatës) në një mënyrë që është në kundërshtim me Marrëveshjen e Grantit ose Kontratën, sipas rastit.

SKEDULI 4

KONTRIBUTE JOMONETARE

Agjencia e Zbatimit të programit siguron kontribute në natyrë në formën e hapësirave të zyrave, lidhje për komunikim dhe mbështetje logjistike etj. për të lehtësuar livrimin e Zërave të Financuar nga Granti.

SKEDULI 5

RAPORTIMI GJYSMËVJETOR

	Periudhat e raportimit			Të akumuluar deri më
	dd.mm.vvvv– dd.mm.vvvv	dd.mm.vvvv– dd.mm.vvvv	dd.mm.vvvv– dd.mm./vvvv	Që prej dd.mm.vvvv
Sitet e Trashëgimisë Kulturore				
Numri i siteve të përfunduara të Trashëgimisë Kulturore				
Vlera totale e siteve të përfunduara të Trashëgimisë Kulturore (EURO)				
Vlera totale e disbursuar, sipas Grantit të BE-së e përdorur për financimin e restaurimit, përmirësimit dhe/ose zhvillimit të pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore (EURO)				
Numri i siteve të Trashëgimisë Kulturore sipas kujdesit të duhur teknik				
Numri i siteve të Trashëgimisë Kulturore me projekte të detajuara të përfunduara por që nuk janë tenderuar				
Numri i siteve të Trashëgimisë Kulturore të tenderuara				
Bashkëpunimi Teknik për Përfshirjen Gjimore dhe Ekonomike				



Numri i ofruesve të shërbimeve/produkteve të turizmit vendas të trajnuar në krijimin e ofertave të turizmit kulturor dhe kombëtar, duke përfshirë hulumtimin dhe studimin e tregut, mjetet promocionale				
Numri total				
Numri i grave të trajnuara				
Numri i burrave të trajnuar				
Numri i ekspertëve të institucioneve publike dhe siteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore përkatëse të trajnuar në restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore				
Numri total				
Numri i grave të trajnuara				
Numri i burrave të trajnuar				
Bashkëpunimi Teknik me drejtim në Turizëm				
Numri total i paketave të reja të turizmit të zhvilluara në Berat, Korçë, Fier dhe Shkodër				
Numri i paketave të reja të turizmit të zhvilluara në Berat				
Numri i paketave të reja të turizmit të zhvilluara në Korçë				
Numri i paketave të reja të turizmit të zhvilluara në Fier				
Numri i paketave të reja të turizmit të zhvilluara në Shkodër				
Numri total i nismave bashkëpunuese vendëse në Berat, Korçë, Fier dhe Shkodër				
Numri i nismave të reja bashkëpunuese në Berat				
Numri nismave të reja bashkëpunuese në Korçë				
Numri total i nismave të reja bashkëpunuese në Fier				
Numri total i nismave të reja bashkëpunuese në Shkodër				

SKEDULI 6 KRITERET E PRANIMIT PËR NËNPROJEKTET

Komponenti A. Për Infrastrukturën e bashkisë dhe të transportit që mundëson turizmin Nënprojektet, në kuadër të Komponentit A – kriteret e pranimi mbështeten në tre komponentë: i. analiza e vendimit me shumë kriterë; ii. analiza sfidë-zgjidhje; dhe iii. Norma Ekonomike e Brendshme e Kthimit (EIRR) mbi 5 për qind.

Për sitet e trashëgimisë kulturore që do të financohen vetëm nga Financimi nga Granti, në kuadër të Komponentit A – Zërat e Financuar nga Granti që do të financohen në kuadër të pjesës 2.B, të skedulit 1 (Zërat e Financuar nga Granti) në Marrëveshjen e Grantit, i përmbushin kriteret e mëposhtme të pranimi, mbështetur në dy komponentë: i. multianaliza e vendimit me shumë kriterë; dhe ii. analiza sfidë-zgjidhje. Sitet e

trashëgimisë kulturore nuk iu nënshtrohen kriterëve EIRR. Financimi nga Granti për restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e siteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore do të përdoret vetëm në bashkitë e Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës (Qarqet e Caktuara).

Pikëzimi total i ponderuar për pikët sipas dy analizave me ponderimin e mëposhtëm: 70 për qind për analizën me kriterë të shumëfishta dhe 30 për qind për analizën sfidë-zgjidhje. Në mënyrë që të financohet një nënprojekt, Nënprojekti duhet të arrijë një pikë mesatare të ponderuar prej 2.50 dhe në rastin e Nënprojekteve të Infrastrukturës, një EIRR i pranueshëm (mbi 5 për qind).

i. Analiza e kriterëve të shumëfishta

Analiza e kriterëve të shumëfishta përfshin tri nivele kriteresh me ponderim të ndryshëm të ndikimit të tyre në pikëzimin përfundimtar të projektit.



Faktorët/pikët e vendimmarrjes		1 (e ulët)	3 (e mesme)	5 (e lartë)
Ndikimi i turizmit (ponderimi 75 për qind)	Ndikimi i rritjes së numrit të vizitorëve (ditor dhe që kalojnë natën)	Deri në 5% rritje	5% deri në 10%	Mbi 10%
	Kohëzgjatja e qëndrimit	0.0–0.1	0.1–0.2	mbi 0.2
	Përqindja B/C e të ardhurave nga turizmi	Më pak se 1		Mbi 2
	Gjenerimi direkt/indirekt i punësimit	Deri në 10	10 deri në 30	Mbi 30
	Ndikimi në produktin turistik dhe përvojën e turistëve	Pa ndikim ose ndikim i ulët në zhvillimin e produktit	Përmirësimi i produktit ekzistues	Produkt i ri
	Ndikimi në ndërgjegjësimin për turizmin dhe krijimin e imazhit	Pa ndikim ose ndikim i ulët kombëtar	Ndikim kombëtar	Ndikim kombëtar dhe ndërkombëtar
Maturimi i Projektit (ponderimi 15 për qind)	Faza e maturimit të projektit	Ideja e projektit/vizioni i projektit	Projektimi paraprak dhe parafizibilitetit	Nivel i lartë i përgatitjes së studimit të fizibilitetit dhe/ose projektimit të detajuar
Mbështetja e Projektit (ponderimi 10 për qind)	Sinergji midis projektit të donatorit/bashkisë lidhur me zhvillimin	Nuk ka lidhje	Lidhje në nivel bashkie	Ka lidhje
	Vullnet/gatishmëri bashkiake për mbështetjen e nismës	Nuk ka mbështetje të konsiderueshme bashkiake	Mbështetje gjatë përgatitjes së Projektit	Aftësi/gatishmëri për zbatimin e projektit
	Vullnet/gatishmëri kombëtare për mbështetjen e nismës	ID-ja e Projektit nuk mbështetet (konfirmohet) në nivel kombëtar	Nuk zbatohet	ID-ja e Projektit mbështetet (konfirmohet) në nivel kombëtar

ii. Analiza sfidë-zgjidhje:

Duke u bazuar në sfidat e identifikuar për secilën nga Qarqet e Caktuara, studimi shqyrtues i zhvillimit të turizmit në Shqipëri, më datë 14 qershor 2018, përgatitur nga Horwath HTL (Studimi Shqyrtues) ka vlerësuar secilën nga sfidat që pengon zhvillimin e turizmit me pikët: 1 (e ulët), 3 (e mesme) dhe 5 (e konsiderueshme). Rezultati i kësaj qasjeje është një përmbledhje e sfidave të identifikuar për secilën bashki sipas shkallës që sfida po kufizon zhvillimin e turizmit.

Secila prej sfidave u ballafaqua me sfidën e identifikuar në secilin prej Qarqeve të Caktuara nga perspektiva se sa mirë projekti i propozuar trajton sfidën e identifikuar në mënyrën e mëposhtme: Ndikim 1 (i ulët), 3 (i mesëm) dhe 5 (i konsiderueshëm) në trajtimin e sfidës.

Komponenti B

Nënprojektet e Infrastrukturës në mbarë territorin e Huamarrësit – Kriteret e pranimit për të identifikuar Nënprojektet varen nga fakti nëse nënprojekti i përket sektorit të transportit (rrugë) apo nëse nënprojekti lidhet me infrastrukturën e bashkisë (furnizimi me ujë, ujërat e ndotura, ndriçimi i rrugëve, mbetjet e ngurta etj.).

i. Kriteret e pranimit për Nënprojektet e Infrastrukturës së bashkisë

Investimet për Infrastrukturën e bashkisë do të përcaktohen duke u bazuar në një vlerë të EIRR-së mbi 5 për qind.

ii. Kriteret e pranimit për Nënprojektet e Infrastrukturës së transportit

Investimet për Infrastrukturën e transportit do të përcaktohen duke u bazuar në:



A. një vlerë të EIRR-së mbi 5 për qind; dhe

B. nëse rruga lehtëson lidhjen dhe aksesueshmërinë në Parqet Kombëtare të Shqipërisë dhe/ose seksioneve të tjera me interes turistik (Po/Jo).

Të përgjithshme

Agjencia e Zbatimit të Programit mund t'u referohet gjetjeve të Studimit Shqyrtues për qëllime të vlerësimit të Nënprojekteve të mundshme të identifikuar në atë dokument, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara më sipër.

VENDIM

Nr. 887, datë 4.11.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË BASHKISË KURBIN E KAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e granteve nga fondi i rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në vlerën 296 969 254.28 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë) lekë.

2. Bashkia Kurbin caktohet si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, i

transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 888, datë 11.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT, MËNYRAT DHE PROCEDURAT E DHËNIES NË PËRDORIM DHE TË TJETËRSIMIT TË PASURIVE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 34, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 27, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ADMINISTRIMI I PASURIVE TË KONFISKUARA

1. Të gjitha pasuritë e konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të



forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” i nënshtrohen procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në vijim “AAPSK”, vendimin e gjykatës të formës së prerë, për konfiskimin e pasurisë, e përcjell tek institucionet përgjegjëse për të kryer kalimin e pronësisë në emër të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Pagesat e shërbimeve të administrimit të pasurive të konfiskuara përballohen nga fondet e AAPSK-së, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, deri në momentin e dhënies në përdorim apo tjetërsimin e pasurisë.

4. Mënyra e përdorimit apo e tjetërsimit të pasurive të konfiskuara vendoset nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, në bazë të raportit tekniko-financiar dhe të nevojave të institucioneve të përcaktuara në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

II. FORMAT E PËRDORIMIT TË PASURIVE TË KONFISKUARA DHE PROCEDURA E DHËNIES NË PËRDORIM

1. Format e përdorimit të pasurive të konfiskuara janë, si më poshtë:

a) kalimi në përgjegjësi administrimi për institucionet qendrore dhe kalimi në përdorim për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) dhënia në huapërdorje, për subjektet e tjera përfituese;

c) dhënia me qira.

2. Procedura e dhënies në përdorim për institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet, si më poshtë vijon:

2.1 Institucioni qendror dhe/apo njësia e vetëqeverisjes vendore, që kërkon përdorimin e pasurisë së konfiskuar, duhet të paraqesë një kërkesë pranë AAPSK-së ku të përcaktohet shprehja e interesit të motivuar e të argumentuar.

2.2 AAPSK-ja parashtrohet kërkesat e institucioneve qendrore dhe të njëjtit të vetëqeverisjes vendore, në lidhje me marrjen në përdorim të pasurive të konfiskuara, në takimin e radhës së Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar.

2.3 Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar vendos për dhënien në përdorim të pasurive të konfiskuara, sipas rëndësisë dhe prioritetit të kërkesës së institucionit qendror dhe/apo njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2.4 AAPSK-ja mbikëqyr veprimtarinë e përfituesit në përdorimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2.5 Përfituesi i raporton çdo 6 (gjashtë) muaj AAPSK-së mbi mënyrën e përdorimit të pasurisë, aspektet e shfrytëzimit të saj, gjendjen dhe problematika të tjera.

2.6 Agjencia i raporton 1 (një) herë në vit Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, për pasuritë e konfiskuara të dhëna në përdorim si dhe paraqet raporte, me kërkesë të këtij të fundit.

III. PROCEDURAT E DHËNIES NË HUAPËRDORJE DHE DHËNIES ME QIRA

1. Kryeadministratori mund t'i kërkojë Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar miratimin për dhënien me huapërdorje të pasurisë së konfiskuar, për subjektet e tjera përfituese, duke i paraqitur argumentet përkatëse.

2. Dhënia me qira e pasurive të konfiskuara do të përdoret nga Agjencia si forma kryesore të sigurimit të të ardhurave nga administrimi i pasurive të konfiskuara.

3. Procedurat e dhënies me qira ndjekin parimet e përgjithshme dhe bazohen në legjislacionin në fuqi për detyrimet dhe kontratat, si dhe ecurinë e tregut të lirë.

4. Për caktimin e çmimeve të dhënies me qira, kryeadministratori ngre rast pas rasti një komision për vlerësimin e tregut, i cili duhet të bëjë vlerësimin e tregut duke u bazuar në:

a) akte ligjore në fuqi, që përafrojnë vlerësimin me zonat kadastrale ku ndodhet pasuria;

b) vlerësimin e ekspertit;

c) çmimet e aplikuara në zonën përreth pasurisë së konfiskuar;



ç) çmimet zyrtare për objekte të së njëjtës natyrë;

d) kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.

5. Komisioni ngrihet nga kryeadministratori, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, të ndryshuar, dhe përbëhet nga administratori i pasurisë dhe 2 (dy) përfaqësues të AAPSK-së, të cilët caktohen nga kryeadministratori.

6. Menjëherë pas caktimit të çmimit të qirasë, në rast se pranë Agjencisë ka shprehje interesi për marrjen me qira, kryeadministratori do të lidhë kontratën e qirasë për pasurinë.

7. Kontrata e qirasë hartohet mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

8. Kryeadministratori i AAPSK-së lidh kontratën e qirasë me atë subjekt juridik/fizik, i cili ka paraqitur shprehje interesi me shkrim për marrjen me qira dhe ka paraqitur ofertën më të lartë.

9. Në kushtet e mungesës së kërkesës së tregut për qiramarrje, pasi pasuria është publikuar 2 (dy) muaj radhazi dhe nuk ka shfaqje interesi, administratori i pasurisë i kërkon kryeadministratorit të AAPSK-së miratimin për aplikimin e çmimeve më të ulëta sesa çmimet e dhëna nga komisioni i ngritur sipas pikës 4, të këtij kreu. Kryeadministratori mund të miratojë çmime të qirasë deri në masën e 30% më ulët se çmimi i propozuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

IV. PROCEDURAT PËR TJETËRSIMIN E PASURISË SË KONFISKUAR

1. Kryeadministratori i AAPSK-së, në rastet e tjetërsimit të pasurisë së konfiskuar, ngre një komision për vlerësimin e pasurive të konfiskuara.

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) një specialist i AAPSK-së;
- b) një specialist ekonomist/jurist i AAPSK-së;
- c) një ekspert vlerësues i licencuar.

3. Vlerësimi i pasurisë bëhet nga komisioni i vlerësimit i ngritur për këtë qëllim, në zbatim të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e pasurive, duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut, si dhe duke pasur parasysh llojin e pasurisë, të dhënat e saj, gjendjen fizike, vendndodhjen, destinacionin ekonomik etj.

4. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e kryer dhe për dokumentet e

hartuara e të nënshkruara prej tij (genplane, situacione, akt vlerësime etj.).

5. Komisioni nxjerr vlerësimin përfundimtar, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë si amortizimi etj., që ndikojnë në vlerën reale të pasurisë.

6. Raporti i vlerësimit të çmimit të shitjes shoqërohet me raportin e vlerësimit të pasurisë nga eksperti i licencuar dhe, në rastet e shoqërive tregtare, nga raporti i audituesit ligjor.

7. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike autorizon kryeadministratorin e AAPSK-së, rast pas rasti, për emërimin e audituesit ligjor.

8. Me propozim të AAPSK-së, Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar vendos për tjetërsimin e pasurisë së konfiskuar, duke e kaluar atë:

a) në pronësi të institucioneve qendrore dhe/apo njërive të vetëqeverisjes vendore.

b) për shitje me ankand.

V. SHITJA ME ANKAND

1. Shitja e pasurive të konfiskuara bëhet me ankand publik, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transferohet dhe procedurat e shitjes”, të ndryshuar. Procedura e ankandit kryhet nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë. Në komisionin e ankandit merr pjesë edhe një përfaqësues i AAPSK-së, si anëtar.

2. Dosja me dokumentacionin ligjor dhe vlerësimin përfundimtar përcillet pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë. Dosja përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë referuar dispozitave ligjore mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë dhe dispozitave ligjore mbi administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;

b) Procesverbalin për gjendjen fizike të pasurisë në çastin e shitjes, të mbajtur sipas formatit të caktuar nga AAPSK-ja;

c) Dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë (vërtetim hipotekar+kartelë dhe certifikatë pronësie, nëse ka);



ç) Aktin e vlerësimit të çmimit të shitjes së pasurisë, të mbajtur nga komisioni përkatës;

d) Kopje të raportit tekniko-financiar, për pasurinë e konfiskuar.

3. Pasuria nxirret në ankand 2 (dy) herë radhazi, në interval kohor jo më pak se 1 (një) muaj nga ankandi i parë. Në ankandin e dytë do të zbatohet i njëjti çmim si në ankandin e parë.

4. Në rast se në ankandin e zhvilluar për herë të dytë nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerje, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë organizon një ankand me një çmim 30% me të ulët se çmimi fillestar, brenda një periudhe kohore 1-mujore nga ankandi i dytë.

5. Në rast se edhe në ankandin me çmim të ulur pasuria nuk shitet, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë kthen dosjen e vlerësimit të pasurisë në AAPSK.

6. AAPSK-ja e dërgon dokumentacionin pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, i cili mund të vendosë për ulje të çmimit të shitjes apo ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurisë.

7. Pasuritë, të cilat nuk janë shitur dhe që kanë kaluar dy ankandet, sipas pikave 3 dhe 4, të kreut V, të këtij vendimi, do t'i nënshtrohen të njëjtës procedurë të shitjes të përcaktuar në këtë vendim.

8. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, pasi ka pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, ndërmerr hapat përkatës për botimin e njoftimit për shitje të objektit, si më poshtë vijon:

a) botimin e listës së objekteve, që do të shiten dhe shpalljen e kësaj liste në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, me të dhënat për çdo objekt;

b) struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë dërgon pranë AAPSK-së njoftimin për zhvillimin e ankandit me të dhënat përkatëse;

c) brenda afatit të publikimit, AAPSK-ja dërgon zyrtarisht procesverbalin e vendosjes së afisheve në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

9. Periudha e botimit zgjat 21 (njëzet e një) ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim

të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Dita e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin e dërguar nga kjo drejtori për botim.

10. Brenda këtij afati, ky njoftim botohet edhe në një Buletin të Njoftimeve Zyrtare, me qarkullim kombëtar.

11. Njoftimi për botim përmban të dhënat për:

a) vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;

b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që do të shitet;

c) vlerën fillestare të ankandit;

ç) sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt.

12. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë strukturë, si dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

13. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë harton dhe arkivon një procesverbal, ku të përcaktohen:

a) kopja e Buletinit të Njoftimeve Publike;

b) kopja e njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare;

c) kopja e procesverbalit të njoftimit me afishe.

14. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, në komisionin e ankandit, këto dokumente:

a) kërkesën me shkrim për blerjen e objektit;

b) garancinë bankare (apo mandatpagesën) që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të AAPSK-së;

c) deklarin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

15. Komisioni i ankandit kryesohet nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë i autorizuar nga titullari i kësaj strukture dhe ka në përbërje edhe 2 (dy) anëtarë të tjerë, konkretisht:

a) përfaqësuesin e AAPSK-së;



b) përfaqësuesin e strukturës përgjegjëse për pronat publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

16. Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

17. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

a) regjistron dhe vërteton identitetin e pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë të përfaqësimit;

b) prezanton anëtarët e komisionit të ankandit;

c) deklaron vlerën fillestare të ankandit;

ç) deklaron hapin e dhënies së ofertave për pjesëmarrësit në ankand;

d) drejton marrjen e ofertave;

dh) shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues të ankandit;

e) siguron që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

18. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, në të cilin shënohen:

a) regjistrimi i identitetit të pjesëmarrësve në ankand sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së veçantë të përfaqësimit;

b) emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;

c) deklarimi i vlerës fillestare të ankandit;

ç) deklarimi i hapjes së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) shpallja e personit të fundit, i cili deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

19. Komisioni i ankandit duhet të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

20. Procesverbali i ankandit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

21. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, iu kthehet 20% e vlerës fillestare, e ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

22. Personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit, pajiset me autorizim për kalim pronësie, nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse

për financat dhe ekonominë, ku përcaktohen qartë detyrimet e blerësit.

23. Blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, është i detyruar të bëjë pagesën në lekë të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand për objektin.

24. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, ai, si fitues ankandi, humbet të drejtën e blerjes dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Pagesa 20% e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e ankandit në vazhdimësi, sipas këtij vendimi.

25. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, pas pagesës së vlerës së plotë të objektit, është e detyruar ta lidhë kontratën e shitjes ndërmjet palës shitëse (përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë dhe përfaqësuesi i AAPSK-së dhe blerësit privat.

26. Përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, përfaqësuesi i AAPSK-së janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit që shitet, brenda 35 (tridhjetë e pesë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, nga struktura përgjegjëse për pronat publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, blerësit.

27. Dorëzimi i objektit bëhet, në mënyrë të detyrueshme, nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë dhe përfaqësuesi AAPSK-së (sipas komisionit të vlerësimit të ngritur) në prani të blerësit.

28. Të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi u zbriten detyrimet, derdhen në llogarinë e AAPSK-së. Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar realizon ndarjen e fondit, si më poshtë vijon:

a) në buxhetin e shtetit;

b) në fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;

c) në përdorim të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.



29. Veprimet kryhen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

30. Vendimi nr. 632, datë 23.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009”, i ndryshuar, shfuqizohet.

31. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 889, datë 11.11.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 82, DATË 14.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në fund të fjalisë së nënpikës 1.2, të pikës 1, shtohen fjalët “... dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët”.

2. Pas pikës 2 shtohet nënpika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen

dhe shpërndarjen e karburantit, që prokurohet për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 21, datë 14.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 8451/4, DATË 5.1.2015, “PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 8451/4, datë 5.1.2015, “Për çaktimin e çmimit dhe tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çmimi i shitjes së çdo botimi, përfshirë dhe Fletoren Zyrtare, llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për faqe është 4 (katër) lekë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për botimet me lidhje speciale, çmimi total i botimit është i barabartë me çmimin e prodhimit (4 lekë për numër faqesh) plus 250 lekë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Botimet, përfshirë edhe Fletoren Zyrtare, mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra e Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Paga kryhet në llogaritë e thesarit në



sistemin bankar për llogari të Qendrës së Botimeve Zyrtare.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM
Nr. 6, datë 2.11.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË
18.11.2016, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN
E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 5 dhe 17 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 11, paragrafi i parë i pikës 6, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Autoriteti i licencimit ose personi të cilit i delegohet kjo kompetencë, nëpërmjet një Komisioni Vlerësues të përcaktuar nga titullari, për zgjedh me konkurs të hapur, subjektin kandidat

për të operuar në një linjë të rregullt ndërqytetëse udhëtarësh, në rastet kur:”.

Neni 2

Në nenin 13, pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me përmbajtjen si më poshtë:

“3. Në rast se mbajtësi i një licence për linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës), tërhiqet nga operimi ose shpall falimentimin apo autoriteti licencues ka marrë masën e heqjes së licencës, deri në përfundimin e procedurave të konkursit të përzgjedhjes/shpalljes fitues dhe licencimit të një subjekti tjetër për linjën përkatëse, autoriteti licencues mund të lidhë një marrëveshje/kontratë të përkohshme me një subjekt të licencuar për shërbimin në linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës), me qëllim mbulimin dhe vazhdimin pa ndërprerje e këtij shërbimi.

Subjekti mund të ofrojë shërbimin edhe nëpërmjet mjeteve shtesë të marra me qira, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 16 të këtij udhëzimi. Në këtë rast, autoriteti licencues duhet të pajisë subjektin me autorizim të përkohshëm, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (lidhja 1).

Afati i autorizimit vendoset nga autoriteti licencues, në përputhje me kushtet dhe afatet procedurale të pajisjes me autorizim, duke garantuar mbulimin dhe vazhdimin e plotë të shërbimit gjatë kësaj periudhe.

4. Në çdo rast të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, subjekti, i cili do të tërhiqet, ka shpallur falimentimin apo i hiqet licenca, ka detyrimin të mbulojë me shërbim linjën deri në 1 (një) muaj pas njoftimit për tërheqje ose fillimit të procedurave të falimentit, apo marrjes së vendimit për heqjen e licencës, nëse do të kërkohet nga autoriteti licencues.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**Lidhja 1**

Faqja e parë e autorizimit nr. _____

Format A4, ngjyra e verdhë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
AUTORITETI KOMPETENT**AUTORIZIM NR. _____****Për kryerjen e përkohshme të shërbimit të rregullt qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës¹⁷ të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit****Mbajtësi i këtij autorizimi** _____

(emri i plotë ose emri tregtar i subjektit):

Me seli në: _____ (adresa e plotë e subjektit)**Numri i NUIS/NIPT-it:** _____**Emërtimi dhe numri i linjës së rregullt¹⁸:** _____

është i autorizuar të kryejë shërbime për të tretë ose me qira të udhëtarëve të përcaktuara në faqen 2, të këtij autorizimi, në përputhje me ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe të certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, dhe kushteve të vendosura në këtë autorizim.

Lëshuar, më ____ . ____ . _____**E vlefshme deri më** ____ . ____ . _____._____
Titulli, emri, nënshkrimi dhe vula
(e autoritetit kompetent)**Lidhja 1**

Faqja e dytë e autorizimit nr. _____

Format A4, ngjyra e verdhë

SHËRBIM I RREGULLT
(QYTETËS, RRETHQYTETËS DHE NDËRQYTETËS)¹⁹**Linja:** _____**Itinerari:** _____

a) Vendi i nisjes të shërbimit: _____

b) Vendi i destinacionit të shërbimit: _____

c) Pikat ku hipin dhe zbresin udhëtarët: _____

Frekuenca: _____**Oraret:** __________
Nënshkrimi dhe vula
(e autoritetit kompetent që e lëshon)¹⁷ Përdoret vetëm emërtimi i linjës së cilës i përket (qytetës, rrethqytetës ose ndërqytetës), hiqen të panevojshmet.¹⁸ Përdoret vetëm emërtimi dhe numri i linjës së cilës i përket (qytetës, rrethqytetës ose ndërqytetës), hiqen të panevojshmet.¹⁹ Përdoret vetëm emërtimi i linjës së cilës i përket (qytetës, ose rrethqytetës ose ndërqytetës), hiqen të panevojshmet.

**Lidhja 1**

Faqja e tretë e autorizimit nr. _____

Format A4, ngjyra e verdhë

Dispozita të përgjithshme

1. Ky autorizim i përkohshëm është lëshuar për shërbimet e rregullta (qytetës ose rrethqytetës, ose ndërqytetës) të udhëtarëve brenda vendit, në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar.

2. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj te një tjetër.

3. Autorizimi origjinal duhet të mbahet nga subjekti. Një kopje e vërtetuar me origjinalin e autorizimit duhet të mbahet në bordin e mjetit dhe paraqitet me kërkesë të organeve të kontrollit. Autorizimi për shërbimet e rregullta lëshohet i shoqëruar me certifikatat e mjeteve.

4. “Shërbimet e rregullta” nënkuptojnë shërbimet të cilat sigurojnë transportin e udhëtarëve në intervale të përcaktuara përgjatë itinerarit të përcaktuar, ku udhëtarët hipin dhe zbresin, në stacione qëndrimi. Këto shërbime kryhen në linja të rregullta qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse.

5. Me marrjen e këtij autorizimi, subjekti mban përgjegjësi për zbatimin e grafikut dhe funksionimin e linjës, sipas orareve të miratuara, si dhe legjislacionit në fuqi për personat me aftësi të kufizuara.

6. Autorizimi është e pavlefshëm, kur:

- a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
- b) është hequr nga autoriteti kompetent.

UDHËZIM**Nr. 609, datë 6.11.2020**

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME
PËR INFORMACIONIN QË DUHET TË
PËRMBAJNË PAKETIMET E
PRODUKTEVE KOZMETIKE, TË CILAT
NUK JANË TË PARAPAKETUARA, QË
PAKETOHEN NË PIKËN E SHITJES
SIPAS KËRKESËS SË BLERËSIT OSE
PARAPAKETOHEN PËR SHITJE TË
MENJËHERSHME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”,

UDHËZOJ:

1. Produktet kozmetike, të cilat nuk janë të parapaketuara, që paktohen në pikën e shitjes sipas kërkesës së blerësit ose parapaketohen për shitje të menjëhershme, duhet të përmbajnë informacionet si më poshtë vijon, referuar pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”:

a) emrin e regjistruar dhe adresën e personit përgjegjës. Informacioni mund të jepet në formë të

shkurtuar, vetëm nëse shkurtimi bën të mundur identifikimin e personit dhe adresës së tij. Në rast të disa adresave, specifikohet adresa e personit përgjegjës, i cili mundëson leximin e dosjes së informacionit të produktit;

b) vendin e origjinës për produktin kozmetik të importuar;

c) përmbajtjen nominale në momentin e paketimit, të dhëna në peshë ose vëllim, me përjashtim të rastit kur paketimi përmban më pak se 5 gr ose 5 ml, mostra dhuruese ose paketime njëpërdorimëshe. Për produktet e parapaketuara, të cilat normalisht shiten veçmas, ku detajet mbi peshën apo vëllimin e tyre nuk janë domethënëse, nuk jepet përmbajtja me kusht që të paraqitet në paketim numri i artikujve. Ky informacion nuk është i nevojshëm nëse numri i artikujve shihet lehtësisht nga jashtë ose nëse produkti normalisht shitet veçmas;

ç) datën deri në të cilën produkti kozmetik, i ruajtur në kushte të përshtatshme, do të vazhdojë të përmbushë funksionin e tij fillestar dhe veçanërisht do të jetë në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Data në vetvete ose detaje të paraqitjes së saj në paketim paraprihen nga simboli i miratuar ose nga fjalët “këshillohet përdorimi para fundit të”. Data e jetëgjatësisë minimale shprehet qartë dhe përbëhet sipas këtij rendi: nga muaji dhe viti ose nga dita, muaji dhe viti. Nëse shihet e



arsyeshme, këtij informacioni do t'i shtohen të dhëna mbi kushtet që duhet të plotësohen, me qëllim garantimin e jetëgjatësisë së deklaruar. Shënimi i datës së jetëgjatësisë minimale nuk është i detyrueshëm për produktet kozmetike me një minimum jetëgjatësie prej më shumë se 30 muajsh. Për produkte të tilla paraqiten të dhëna mbi periudhën pas hapjes së produktit, gjatë së cilës ai është i sigurt dhe mund të përdoret pa e dëmtuar konsumatorin;

d) masat e veçanta që duhen ndjekur për përdorimin, si dhe çdo informacion i veçantë i kujdesit paraprak për produktet kozmetike për përdorim profesional;

dh) numrin e lotit të prodhimit ose referenca për identifikimin e produktit kozmetik. Në rast se për arsye praktike kjo nuk është e mundur, për shkak se produkti kozmetik është tepër i vogël, ky informacion do të paraqitet vetëm në paketim;

e) funksionin e produktit kozmetik, nëse nuk është i qartë nga prezantimi i tij;

ë) listën e përbërësve, informacion i cili mund të tregohet vetëm në paketim, e paraprirë nga termi “përbërësit”. Megjithatë, elementet e mëposhtme nuk do të konsiderohen si përbërës:

i. papastërtitë të lënda e parë e përdorur;

ii. materiale teknike shitesë të përdorura në përzierje, por jo të pranishme te produkti përfundimtar.

Parfumat, përbërjet aromatike dhe substancat e tyre të para do t'i referohen termit “parfum” ose “aromë”. Prania e substancave të parashikuara në kolonën “të tjera”, në “listën e substancave që nuk lejohen të jenë në përbërjen e produkteve kozmetike, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara”, do të paraqitet në listën e përbërësve, përveç termave “parfum” ose “aromë”. Lista e përbërësve hartohet në rendin zbritës të peshës së përbërësve në momentin kur ato i shtohen produktit kozmetik. Përbërësit në përqendrim më të ulët se 1% mund të listohen në ndonjë rend tjetër pas atyre në përqendrim më të lartë se 1%. Të gjithë përbërësit e pranishëm në formën e nanomaterialeve duhet të tregohen në mënyrë të qartë në listën e përbërësve. Emrat e përbërësve të tillë duhet të ndiqen nga fjala “nano” në kllapa. Substancat ngjyuese të ndryshme nga ngjyuesit e flokëve, mund të listohen në një rend tjetër, pas përbërësve të tjerë kozmetikë. Për produktet kozmetike dekorative, që tregtohen në disa nuanca

ngjyrash, me përjashtim të atyre të destinuara për ngjyerjen e flokëve, mund të përmenden vetëm nëse shtohen fjalët “mund të përmbajë” ose simboli “+/-”. Emërtimi” CI (*Color index* – indeksi i ngjyrave) përdoret kur është e zbatueshme.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi duhet të listohet në etiketë, fletëpalosje ose letër ngjitëse të pakten në paketimin dytësor (mund të vendoset brenda paketimit të produkteve kozmetike ose u bashkëngjitet produkteve kozmetike në ambalazhet e tyre) nga personi i cili, në veprimtarinë e “bërjes së disponueshme në treg”, siguron produktin kozmetik te përdoruesi fundor.

3. Nëse informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi nuk mund të etiketohet sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij udhëzimi, për arsye praktikiteti, në veçanti për arsye të përmasës së vogël ose formës së produktit kozmetik, produktet kozmetike duhet të shiten së bashku me një fletë që mban indikacionet e referuara në pikën 1 të këtij udhëzimi (u lidhet një etiketë në paketimin parësor ose në paketimin përfundimtar, në të cilin produkti kozmetik ofrohet për shitje).

4. Për produktet kozmetike, sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”, të vëna në dispozicion në tregun kombëtar, informacioni i referuar në pikën 1 të këtij udhëzimi dhe pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 16, të ligjit të sipërpërmendur duhet të tregohen në gjuhën shqipe. Nëse indikacionet e përmendura në këtë paragraf janë vendosur në disa gjuhë, të njëjtat vendosen, gjithashtu, në gjuhën shqipe, përkthim identik i tekstit original dhe me karaktere të dukshme dhe të lexueshme joinferiore ndaj atyre të përdorur për gjuhët e tjera.

5. Gjithashtu, për produktet kozmetike të cilat nuk janë të parapaketuara ose paktohen nga shitësi me kërkesë të blerësit, ose janë të parapaketuara për shitje të menjëhershme, për fazën e paketimit dhe etiketimit zbatohen parashikimet e nenit 5, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike” dhe parashikimet përkatëse të vendimit nr. 634, datë 26.10.2018, “Për miratimin e parimeve dhe të udhëzimeve të praktikës së mirë të prodhimit të produkteve kozmetike”.

6. Në procesin e etiketimit të produkteve kozmetike, të cilat nuk janë të parapaketuara ose paktohen nga shitësi me kërkesë të blerësit, ose janë të parapaketuara për shitje të menjëhershme,



në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm dhe një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njeriut, zbatohen dispozitat e nenit 16, pikat 2, 3, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”.

7. Informacioni i përmendur në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij udhëzimi, duhet të shprehet duke përdorur emrin e zakonshëm të përbërësit. Nëse nuk është i disponueshëm një emër i zakonshëm për një përbërës të caktuar, do të përdoret një term që përmbahet në një nomenklaturë ndërkombëtare të njohur përgjithësisht.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 610, datë 6.11.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI PËRDORIMIN E
NANOMATERIALEVE NË PRODUKTET
KOZMETIKE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe shkronjës “i”, të pikës “ç”, të paragrafit 1, të nenit 12, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Mbi përdorimin e nanomaterialeve në produktet kozmetike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet pas 18 muajsh nga data e miratimit.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE

**MBI PËRDORIMIN E NANOMATERIALEVE
NË PRODUKTET KOZMETIKE**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është specifikimi i përshkruesve të tjerë që përdoren për lehtësimin e identifikimit të substancave në formën e nanomaterialeve dhe vlerësimi i profilit të nanomaterialeve të përdorura në produktet kozmetike që vendosen në tregun e Republikës së Shqipërisë.

2. Përshkruesit e tjerë, që përdoren për lehtësimin e identifikimit të substancave në formën e nanomaterialeve në produktet kozmetike, janë si më poshtë vijon:

a) emri i përbashkët ndërkombëtar (INN) për barnat, sipas përcaktimeve të bëra nga OBSH-ja në Gjenevë, gusht 1975;

b) numrat e regjistrimit të caktuar nga Shërbimi i Abstraktiveve Kimike (CAS);

c) numri EC që i korresponson ose numrave të substancave kimike tregtare ekzistuese të inventarit evropian, ose numrave të njoftuar të substancave kimike të listës evropiane, ose numrave të regjistrimit sipas Rregullores (EC) 1907/2006;

ç) XAN, që është emri i aprovuar nga një shtet specifik (X), për shembull USAN, që i korresponson emrit të aprovuar të Shteteve të Bashkuara;

d) emri në përmbledhjen e emrave të zakonshëm të përbërësve. Nëse nuk është i disponueshëm një emër i zakonshëm për një përbërës të caktuar, do të përdoret një term që përmbahet në një nomenklaturë ndërkombëtare të njohur përgjithësisht.

3. Aspektet e nanomaterialeve që përbëjnë bazën për shqetësim, në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e përdoruesve kur përdoren në produktet kozmetike përfshijnë:

a) vetitë fiziko-kimike, lidhur me: përmasat shumë të vogla të grimcave: tretshmërinë/qëndrueshmërinë/potencialin e grumbullimit në grup; natyrën kimike dhe toksicitetin e nanomaterialeve; veçoritë fizike/morfologjike të grimcave të përbërësve; karakteristikat e sipërfaqeve (modifikimet/veshjet e sipërfaqes).

b) Aspektet e ekspozimit, që lidhen me frekuencën dhe sasinë e përdorur, në rastet kur numri apo tipi i produktit të përdorur nga përdoruesi është relativisht i lartë dhe në rastet kur



ka një potencial për një ekspozim sistemik të përdoruesit ndaj nanogrimcave.

c) Aspektet e tjera, në lidhje me veçoritë e reja, aktivitetet ose funksionet dhe shqetësimet specifike që lindin nga lloji i aplikimit.

4. Në rast se ka dyshime, në lidhje me sigurinë e një nanomateriali, brenda gjashtë muajve pas informimit elektronikisht nga personi përgjegjës, sipas pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për profilin e nanomaterialit, bazohen në dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) informacionin e dorëzuar nga personi përgjegjës për produktet kozmetike, që përmbajnë nanomateriale, ku përfshihen studime shkencore, informacione nga literatura shkencore e publikuar; opinionet, udhëzimet dhe këshillimet shkencore të dhëna nga Komiteti Shkencor për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Komiteti Shkencor për Shëndetin, Mjedisin dhe Rreziqet e Emergjencës të menaxhuar nga Komisioni Evropian, si dhe burime të tjera zyrtare;

b) metodat e testimit dhe analizat laboratorike përkatëse të kryera në laboratorët e akredituar.

c) informacione shtesë, kur është e nevojshme, të kërkuara personit përgjegjës nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, përveç atyre të përcaktuara në nenin 14, pika 5, e ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”, dhe shkronjën “a”, “b”, të kësaj pike;

5. Në rast se institucionet e përcaktuara në pikën 4 të kësaj rregulloreje, vlerësojnë se bazuar në informacionin e siguruar për nanomateriale, sipas pikës 4 më sipër, produkti kozmetik paraqet rrezik serioz për shëndetin e njerëzve, inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë merr të gjitha masat e parashikuara, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e kozmetikës për të siguruar ndalimin e vendosjes në treg të këtij produkti.

6. Parashikimet e pikës 5 të këtij urdhri vlejné edhe për produktet kozmetike që përmbajnë nanomateriale, të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe janë bërë të disponueshme në treg. Në rast se inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, konstaton se produkti kozmetik paraqet rrezik serioz për shëndetin e njerëzve, merr të gjitha masat e parashikuara, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e kozmetikës për të siguruar që produkti ose produktet në fjalë të tërhiqen nga tregu, të kthehen mbrapsht ose të kufizohet bërja e disponueshme e tyre në treg.

7. Në çdo rast, personi përgjegjës për produktet kozmetike, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”, është përgjegjës për sigurinë dhe cilësinë e produkteve kozmetike të disponueshme në treg të cilat përmbajnë nanomateriale.

8. Referuar shkronjës “a”, të pikës 4, të kësaj rregulloreje, personi përgjegjës për produktet kozmetike që vendosen në treg, duhet të dorëzojë edhe informacionin e mëposhtëm, si vijon për nanomateriale:

A. Lista për karakterizimin e materialit

Informacioni i kërkuar	Për materialin e papërpunuar, siç është prodhuar	Për materialin në formulimin përfundimtar	Për materialin e përdorur për hetim toksikologjik dhe vlerësimin e ekspozimit
Identiteti kimik			
Përbërja kimike			
Madhësia e grimcës (për çdo produkt në formë spërkatësi duhet të sigurohet shpërndarja e madhësisë së pikave pas spërkatjes, si dhe e grimcave të mbetjeve të thara).			
Morfologjia			
Karakteristikat e sipërfaqes			
Tretshmëria			
Hapësira e sipërfaqes			
Aktiviteti katalitik			



Përqendrimi (vetëm për pluhurat e thata)			
Pluhuri (vetëm për pluhurat e thata)			
Dendësia dhe dendësia e derdhjes (Vetëm për materialet e grimcuara)			
Potenciali redoks			
Ph (për tretësirat ujore)			
Viskoziteti (për shpërbërjet e lëngshme)			
Qëndrueshmëria			
Absorbimi UV			
Tjetër			

B. Lista për identifikimin e rrezikut (të dhënat toksikologjike)

Informacioni i kërkuar
Mundësia dhe masa e ekspozimit të brendshëm përmes lëkurës, mushkërive ose rrugës orale, duke marrë parasysh llojin e përdorimit
Absorbimi përmes lëkurës – për produktet e aplikuara në lëkurë
Sjellja biokinetike, agregimi/aglomerimi i konsideruar gjatë testimeve
Toksiciteti akut
Iritimi dhe korroziviteti
Ndjeshmëria e lëkurës
Mutageniciteti/gjenotoksiciteti
Toksiciteti i dozës së përsëritur
Fotoksiciteti - për produktet e destinuar për përdorim në lëkurën e ekspozuar ndaj rrezeve të diellit
Toksiciteti riprodhues
Karcinogjeniteti
Të dhëna të njerëzve (kur është e mundur)
Informacion tjetër i përshtatshëm

C. Lista për informacion lidhur me ekspozimin

Informacioni i kërkuar
Kategoria e produktit kozmetik në të cilin përbërësi ka qëllim për t'u përdorur
Përqendrimi i përbërësit në produktin kozmetik përfundimtar
Sasia e produktit të përdorur në çdo aplikim
Frekuenca e përdorimit
Zona e plotë e kontaktit me lëkurën
Kohëzgjatja e ekspozimit
Përdorimet e parashikuara që mund të rrisin ekspozimin
Grupet e përdoruesve (p.sh., fëmijë; njerëz me lëkurë të ndjeshme ose të dëmtuar), kur kërkohet specifikisht
Sasia që ka të ngjarë të hyjë në trup (fraksioni i absorbuar) për çdo grup-target
Aplikimi në zonat e lëkurës që janë të ekspozuar ndaj rrezeve të diellit
Ekspozimi i vlerësuar i lëkurës, bazuar në qëllimin e përdorimit të produktit
Ekspozimi i vlerësuar i inhalimit, bazuar në qëllimin e përdorimit të produktit
Ekspozimi i vlerësuar oral, bazuar në qëllimin e përdorimit të produktit
Llogaritja e ekspozimit për çdo grup-target
Informacion tjetër i përshtatshëm

9. 18 muaj pas fillimit të efekteve të këtij urdhri, ministria përgjegjëse për shëndetësinë do të bëjë të disponueshëm katalogun e nanomaterialeve, që përdoren në produktet kozmetike të vendosura në treg, përfshirë ato që përdoren si ngjyres, filtra UV dhe konservues - në një seksion të veçantë, duke treguar kategoritë e produkteve kozmetike dhe

kushtet e parashikuara të ekspozimit. Ky katalog do të përditësohet rregullisht dhe do të publikohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

**NJOFTIM**

Nr. 13521, datë 11.11.2020

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar”, nënshkruar më 20.5.2014, ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

NJOFTIM

Nr. 13522, datë 16.11.2020

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit mbi heqjen e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale”, nënshkruar në Doha më 26 mars 2012, ka hyrë në fuqi më 4.11.2020.

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës mbi përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme”, nënshkruar më 27 janar 2020, ka hyrë në fuqi më 11.11.2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Nr. 6278/7, datë 12.11.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga bulevardi ‘Bajram Curri’, bulevardi ‘Petro Nini Luarasi’, rruga “Taulantia”, rruga ‘Ali Demi’, Tiranë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Vlerësimi për objektet e banimit është bërë sipas çmimit mesatar të shitblerjeve për 3 muajt e fundit të objekteve të banimit, të konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë (me shkresën nr. 1394/5 prot., datë 24.8.2020). Vlerësimi për objektet me funksion shërbimi është bërë me situacion, bazuar në çmimet e EKB-së për qytetin e Tiranës, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 522 752 181 (pesëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI ME OBJEKT “RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT” QË KUFIZOHET NGA BULEVARDI ‘BAJRAM CURRI’, BULEVARDI ‘PETRO NINI’ LUARASI, RRUGA ‘TAULANTIA’, RRUGA ‘ALI DEMI’”, TIRANË

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pas.	Sip. e përgj. truall, m ²	Sip. e prekur truall, m ²	Çmimi për truall, lek/m ²	Sip. e përgj. objekt m ²	Sip. e prekur objekt m ²	Çmimi për objekt lek/m ²	Vlera (truall i prekur), lek	Vlera (objekt i prekur), lek	Vlera (truall + objekt), lek	Konfirmim i ASHK-së Tiranë	Shënime
1	Dritan Vakaj	Truall	8150	8/698	325	325	66969				21764925	0	21764925	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	D - Pasuria rivlerësohet në vlerën 16.672.500 lekë, e vlefshme deri në transaksionin e radhës.
2	Bardhyl Hasan Mumajesi	Truall	8150	8/680	1623	1442	66969		0		96569298	0	96569298	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
3	BP. Hysi Liçi	Truall	8150	8/451	294	265	66969				17746785	0	17746785	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	E - Në favor të shoq. “Sahitaj” sh.p.k.
4	BP. Kaimi, Shtiza, Bellova SHOQ. “4 A-M” SH.P.K.”	Truall	8150	8/380	938	674	66969				45137106	0	45137106	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	D - në bazë të urdhrat nr 942 prot., datë 10.9.2008, është bërë korigjimi i pasurisë nr. 8/380.
5	Shtet	Truall	8150	8/736	1038.1	1038.1	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
6	Shtet	Trotuare	8150	8/603	4775	100	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
7	BP Meta	Truall	8150	8/699	153	118	66969				7902342	0	7902342	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
8	BP Ostreni, Mata, Caca	Truall	8150	8/194	2011	1521	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	PV - Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje. E - vendoset barrë hipotekare nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Shkresa nr. 11436 prot., datë 22.1.2018, nr. 1543 prot., datë 23.1.2018. Menaxhuar me leje ndërtimi.
9	Shtet	Shesh	8150	8/199	1959	1712	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	Mbi këtë pasuri bazuar në leje. leg. është regjistruar ndërtesa me nr. pas. 8/199-nd., vol. 61, f. 69.
10	BP Mumajesi, Tafaj, Hyka, Kaimi, Cela, Hoxha, Derhemi, Vakari,	Truall	8150	8/445	430	136	66969				9107784	0	9107784	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	DTR-ja, në referencën 4066, ZK8180; D - Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm.
11	Shtet	Rrugë	8150	8/207	4559	210	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
12	Shtet	Rrugë	8150	8/236	456.4	362	0	0.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
13	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/471	60	60	66969		0		4018140	0	4018140	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
14	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/472	159	56	66969				3750264	0	3750264	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
15	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/473	203	26	66969				1741194	0	1741194	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
16	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/378	195	51	66969				3415419	0	3415419	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	D - Mbi këtë pasuri bie ndërtesa me nr. 8/378-nd. vol. 60, f. 215, përfituar me leje leg. shtesë anësore.
17	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/379	182	104	66969				6964776	0	6964776	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
18	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/377	192	192	66969				12858048	0	12858048	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
19	BP Kërçani, Toro	Truall	8150	8/673	787	787	66969				52704603	0	52704603	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
20	BP Ramilli, Shtiza, Bellova, Lela	Truall	8150	8/476	527	61	66969				4085109	0	4085109	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	D – Në bazë të urdhrat me nr. 942 prot., datë 10.9.2008, është bërë saktësimi i pasurisë nr. 8/476.
21	Abedin Shaban Ymeti	Truall	8150	8/234	166.6	166.6	66969	89.00	89	137981	11157035	12280309	23437344	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	PV - Vendimi nr. 396, datë 20.7.2015 - I AKKP-së.
22	BP Shtiza, Ramilli, Bellova	Truall	8150	8/477	255	45	66969				3013605	0	3013605	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	PV - Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje.



23	BP. Kërçani,	Truall	8150	8/441	737	6	66969				401814	0	401814	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	D - Është mbyllur, certifikata e pronësisë lëshuar me datë 12.9.2007 00017199 01/01/2009, i4 për efekt plotësim të kërkesës së ref. 17198 E - në favor të shoq. “Vigan” sh.p.k.
24	BP Meta	Truall	8150	8/800	453.4	453.4	66969	39.90	39.9	22731.15	30363745	906,972.89	31270717	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
25	BP. Tafa, Çela (Tafa)	Truall	8150	8/361	121	35	66969				2343915	0	2343915	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
26	PPV	Truall	8150	8/235	36.1	36.1	66969				2417581	0	2417581	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	PV - Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje.
27	Shtet	Shesh	8150	8/227	268.8	264	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	PV - Mbi këtë shesh ka ndërtim pa leje.
28	Shtet	Rrugë	8150	8/242	795.5	446	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
29	Shtet	Shesh	8150	8/243	159	125	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
30	Piro Koste Mani	Truall	8150	8/353	179	114	66969				7634466	0	7634466	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	E - Insk. nr. 811, datë 21.8.2002.
31	Shtet	Shesh	8150	8/249	1505	1089	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
32	Shtet	Shesh	8150	8/251	1852.8	85	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
33	Shtet	Truall	8150	8/442	94	81	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
34	BP Mumajesi	Truall	8150	8/589	171	110	66969				7366590	0	7366590	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/5, datë 24. 8.2020	D - Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. 8/893/nd. vol. 63, f. 4.
35	BP Meta	Truall	8150	8/799	164.8	14	66969	101.30	0	0	937566	0	937566	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020	
36	Piro Mani	Truall	8150	8/686	328	264	66969	0.00	0	0	17679816	0	17679816	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
37	Edmond Sotiraq Kushi	Truall	8150	8/688	250	189	66969	0.00	0	0	12657141	0	12657141	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
38	Mirela Kosta Angjeli	Truall	8150	8/689	628	515	66969	0.00	0	0	34489035	0	34489035	Konfirmim me shkresën e ASHK me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	PV - Kërkesë nr. 150 datë 7.5.2015, not. b. vukaj prona rezervohet 30 ditë. D - Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të kryejë veprime mbi kartelën e pasurisë 8/689 ose të kërkojë të kryejë veprime (transaksion), përveç Mirela Angjeli.
39	Menduh Mata, I Asllanit	Truall	8150	8/195	492	336	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	D - Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje. Menaxhuar me leje ndërtimi.
40	Shtet	Trotuare	8150	8/604	61	36	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
41	Shtet	Shesh	8150	8/334	21.7	21.7	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
42	Shtet	Shesh	8150	8/237	455.2	165	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
43	Bardhyl Mumajesi	Truall	8150	8/681	225	225	66969				15068025	0	15068025	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	D - Bilokohet në favor të shoqërisë “Sahitaj Konstruksion” sh.p.k.
44	Shtet	Rrugë	8150	8/132	2773.6	102	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
45	Shtet	Shesh	8150	8/582	177.9	151	0				0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
46	Sanie Mehmet Shtiza	Truall	8150	8/375	94	94	66969	11.00	0	0	6295086	0	6295086	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
47	BP Ereqi, Meçani	Truall	8150	8/187	735	65	66969	0.00	0	0	4352985	0	4352985	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	PV- Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje.
48	Piro Mani	Truall	8150	8/690	1494	583	0	136.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	E - Në favor të shoq. “AM & AN” sh.p.k. Sipas kontratës së sipërmarrjes. Menaxhuar me leje ndërtimi.
49	Bendis Piro Mani	Truall	8150	8/691	937.2	860	0	0.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr.	E – Në favor të shoq. “AM & AN”



	Ventiola Piro Mani													prot. 1394/5, datë 24.8.2020	sh.p.k. Sipas kontratës së sipërmarrjes. Menaxhuar me leje ndërtimi.
50	BP Shtiza	Truall	8150	8/233	347	347	66969	180.00	180	137981	23238243	24836580	48074823	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
51	Dolcka Sh.p.k.	Pallat	8150	8/815	2398	535	0	1344.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	Mbi truallin e këtij pallati ndodhen pasuritë: 8/409 v. 19, f. 99, 8/407 v. 19, f. 97, 8/674 v. 90, f. 222, 8/410 v. 19 f. 100 8/406, v. 19, f. 96, 8/408, v. 19, f. 98, 8/404, v. 19, f. 96, 8/405, v. 19, f. 95, 8/411, v. 19, f. 101. Menaxhuar me leje ndërtimi.
52	Hamit Qoshja, Banush Cela, Vijon në vol. 40 f. 223, 224, 225	Truall	8150	8/588	457	173	66969	122.00	0	0	11585637	0	11585637	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	Banesë 3-katëshe me sip. banimi 122 m ² . Regjistruar me lejen e ndërtimit nr. 33, datë 18.2.1998 nga Bashkia Tiranë. Pasuria rivlerësohet shumën 11.919.400 lekë.
53	BP Mumajesi	Truall	8150	8/590	120	45	66969	0.00	0	0	3013605	0	3013605	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
54	Shtet	Shesh	8150	8/354	158.4	117	0	0.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
55	Shtet	Rrugë	8150	8/193	719.7	560	0	0.00	0	0	0	0	0	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020	
56	Qamil Mustafa Bozaxhiu	Truall	8150	8/452	108	44	66969	0.00	0	0	2946636	0	2946636	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020	
57	Menaxhuar me leje ndërtimi	Truall	8150	8/231		80	0	0.00	0	0	0	0	0		
Shuma						17818					484728319	38023862	522752181		

Shënim:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresat nr. prot. 1394/1, datë 23.7.2020, nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020, nr. prot. 1394/5, datë 24.8.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Veri.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet e banimit, vlerësimi është bërë sipas çmimit mesatar të shitblerjes për 3 muajt e fundit të objekteve të banimit, përcjellë me shkresën nr. prot. 1394/5 datë 24.8.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me vlerën 137.981 lekë.
4. Për objektin me nr. pas. 8/800, ZK 8150, me funksion shërbimi, vlerësimi është bërë sipas kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e EKB-së, për qytetin e Tiranës, ku sipas situacionit të punimeve vlera për m² =22731.15 lekë.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3996, datë 5.10.2020, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Florenc Bame, i lindur më datë 24.3.1975, në Gur-Lushnjë, dhe me banim të fundit në Njësinë Bashkiake nr. 2, Tiranë, duke përcaktuar si datë vdekjeje datën 1.1.1995, si dhe caktimin e kërkuesit Thami Bame si kujdestar të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shtetasit Florenc Bame.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë